



**UNIVERSITETI I TIRANËS  
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA  
DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE**

**PROCESI I PËRKTHIMIT TË *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* NË GJUHËN SHQIPE**

**Udhëheqës shkencor:  
Prof. Dr. Nonda VARFI**

**Kandidate:  
MA Adelina ALBRAHIMI**

dhjetor, 2014

**Fjalët kyçe:** *acquis communautaire*, përkthim, gjuhë, terminologji, aftësi, ekspert përkthyes

**Key words:** *acquis communautaire*, translation, language, terminology, skills, expert

**ABSTRAKT:**

Bazuar në hulumtimet në fushën e përkthimit, në fushën e përkthimit ligjor, në literaturën në dispozicion, kryesisht në gjuhën angleze dhe në gjuhën shqipe, por edhe në gjuhë të tjera, konsultimet me përkthyes, interpretë, juristë të njohur, punonjës të institucioneve qeveritare që i përdorin shpesh shërbimet e përkthimit, si dhe duke pasur parasysh përvojën e saj si mësimdhënëse në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës, dhe përvojën në fushën e përkthimit, në këtë punim autorja ka trajtuar të gjithë procesin e përkthimit të *acquis communautaire* në gjuhën shqipe, duke analizuar nivelin e duhur gjuhësor që i nevojiten personave të interesuar për t'u marrë me përkthimet e *acquis communautaire*, paradigmën e aftësive, problemet kryesore të hasura në përkthimin e *acquis communautaire*, si dhe duke ofruar sugjerime për zgjidhje të mundshme përkthimore, veçanërisht për studentët dhe për përkthyesit e rinj që dëshirojnë të angazhohen në përkthimin e mijërave faqeve legjislativ të Bashkimit Evropian që Shqipërisë do t'i duhet të përkthejë gjatë viteve në vijim. Megjithëse ky punim nuk është shterues lidhur me zgjidhjet për problemet përkthimore dhe trajtimin e çështjeve të shumta të debatueshme përkthimore të *acquis communautaire*, autorja shpreson që ai të shërbejë si instrument i mirë reference për të gjithë ata që janë të interesuar të angazhohen në procesin e përkthimit të *acquis communautaire* në shqip.

**INFORMACION RRETH AUTORES:**

Adelina Albrahimi  
Fakulteti i Gjuhëve të Huaja  
Departamenti i Gjuhës Angleze  
Rruga e Elbasanit, Tiranë  
adelina.albrahimi@gmail.com

***Përligjja e temës***

*Kjo temë disertacioni mbi procesin e përkthimit të *acquis communautaire* në gjuhën shqipe u përzgjedh për arsyt e mëposhtme:*

*Një ndër aspiratat më të mëdha të Shqipërisë është anëtarësimi në Bashkimin Evropian (BE), gjë që kërkon punë të madhe për arritjen e standardeve. Në mënyrë që të përmbushen e të vihen në jetë këto standarde, ato duhet të paraprihen e të udhëhiqen nga procesi i njohjes së tyre, i cili më pas duhet të shoqërohet nga përvetësimi i tyre në një nivel të kënaqshëm për shtetet anëtare të Bashkimit Evropian. Prosesi paraprijës ka rëndësi shumë të madhe, e nënkupton për momentin përafrimin e legjislacionit të BE-së (*acquis communautaire*) me legjislacionin shqiptar, e më pas (kur Shqipëria të bëhet anëtare e BE-së), njehsimin e legjislacionit të BE-së me legjislacionin shqiptar. Me fjalë të tjera ky proces çkodimi dhe kodimi, apo procesi i përkthimit, fillon më parë sesa procesi i punës fizike për përkthimin, dhe në rastin e *acquis communautaire* ka pasoja të drejtpërdrejta dhe të shtrira në kohë. Ai duhet parë jo vetëm në aspektin gjuhësor, por dhe në aspektin social, kulturor, e politik, pasi luan rol shumë të madh në evropianizimin e Shqipërisë e në mbarëvajtjen e procesit të integritimit në përgjithësi, pa mohuar dhe ndikimin mbi gjuhën shqipe.*

*Duke qenë se Shqipëria është ende në fillim të këtij procesi, është detyra e gjuhëtarëve e përkthyesve të luajnë rol të rëndësishëm për të ruajtur gjuhën shqipe e për të vënë ca themele që do të bashkëshoqërojnë këtë proces të rëndësishëm. Për ta lehtësuar pak këtë proces nga barra e madhe dhe nga vështirësitë që ai mbart për përkthyesit, është shumë e rëndësishme jo vetëm të njihet shumë mirë gjuha amtare dhe sistemi i brendshëm juridik i Shqipërisë, por edhe gjuha e huaj dhe rendi juridik i BE-së.*

*Fakulteti i Gjuhëve të Huaja është ofruesi kryesor i përkthyesve në treg, e si rezultat, autorja e këtij punimi është e mendimit se ky punim do t'u shërbejë si pikë e mirë nisjeje studentëve të përkthimit të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja dhe përkthyesve të rinj për të qenë më mirë të përgatitur për të përballuar sfidat e ndryshme që do t'u duhen të zgjidhin gjatë procesit të përkthimit të *acquis communautaire*. Shumë nga sugjerimet e dhëna në këtë punim kanë ardhur si rezultat i punës disavjeçare të autores dhe të rekomandimeve të nxjerra në bashkëpunim me përkthyes, gjuhëtarë, ekspertë të fushës juridike, ekspertë të teknikës legjislative, redaktorë, e të tjerë.*

*Po ashtu, kërkesa për përkthime nga gjuha angleze është rritur shumë, e paralel me të dhe sfida për profesionin e përkthyesit, posaçërisht lidhur me çështje të cilësisë. Procesi i zgjerimit të BE-së në vitin 2004 u parapri nga një rritje e madhe e kërkesës për përkthime dhe për interpretim nga dhe drejt 'gjuhëve të pakicave', gjuhë të cilat përgjithësisht nuk janë studiuar dhe mësuar si gjuhë të huaja. Ashtu si edhe në rastin e shteteve të reja anëtare në BE, Shqipërisë do t'i duhet të përkthejë mijëra faqe legjislacion të BE-së gjatë fazës së negociatave dhe më pas gjatë anëtarësimit.*

*Ky punim, duke qenë ndër pak studime në këtë fushë, synon të analizojë aftësitë kryesore që nevojiten për dikë për t'u bërë përkthyes, dhe t'u japë zgjidhje problemeve përkthimore që mund të hasen gjatë përkthimit të *acquis communautaire*, duke e konsideruar procesin e përkthimit si zgjidhje problemi.*

*Në këtë mënyrë, punimi rreket të zgjerojë dhe pasurojë njohuritë në lidhje me përkthimin e *acquis communautaire* për studentët e universiteteve tona në veçanti, për përkthyesit e rinj si dhe për të gjithë studiuesit e fushës në përgjithësi.*

*Ky punim është thjesht një përpjekje e parë e autores për të vendosur ca piketa në procesin e përkthimit të *acquis communautaire*, e si i tillë, as nuk mund të pretendohet të jetë*

*shterues dhe as nuk mund të jetë i tillë. Ai është punuar me dëshirën për të ofruar një bazë të mirë për studime të tjera më të thelluara në fushë.*

### **Objekti dhe hipotezat e punimit**

*Eksperienca e vendeve të tjera, veçanërisht e shteteve të anëtarësuara në valën e parë të zgjerimit, dëshmon se procesi i përkthimit të korpusit ligjor të Bashkimit Evropian, i quajtur ndryshe si *acquis communautaire*, është vendimtar për përparimin drejt integritimit në BE. Pa dyshim e njëjta sfidë i pret dhe vendet e Ballkanit Perëndimor që kanë çelur negociatat për anëtarësim në Bashkimin Evropian, përveç Shqipërisë, së cilës iu dha statusi i vendit kandidat në qershor të vitit 2014, dhe Bosnje-Hercegovinës, ende në pritje të marrjes së statusit të vendit kandidat.*

*Pjesa më e madhe e legjislacionit që duhet të përkthejë Shqipëria është legjislacioni dytësor i Komunitetit, i cili sendërtohet nga institucionet e BE-së në formën e akteve të Komunitetit, si për shembull rregulloret, direktivat, vendimet, rekomandimet dhe opinionet. Megjithëse nuk është e domosdoshme që përkthyesit të jenë ekspertë të së drejtës komunitare, është absolutisht e nevojshme që ata të kenë njohuritë të mira mbi Bashkimin Evropian, institucionet e tij, dhe mbi të gjitha mbi tekstet e tij ligjore (përfshirë qëllimet, objektivat, rrethin e personave të cilëve u drejtohen këto instrumente dhe efektet normative të tyre).*

*Puna për përkthimin e korpusit ligjor të BE-së, është një punë shumë e madhe, jo vetëm duke u nisur nga faqet e legjislacionit që duhet të përkthehen, por çfarë është më e rëndësishmja, nga fakti që përkthimet duhet patjetër të ofrojnë **uniformitet, cilësi të lartë dhe besueshmëri ligjore**. Megjithëse përkthyesit në të ardhmen e afërt dhe të mesme do të duhet të punojnë kryesisht drejt gjuhës shqipe, është shumë*

*e rëndësishme të theksohet se gjuha e *acquis communautaire* është standarde dhe si e tillë, kërkon përkthimin në shqip sipas frazave dhe fjalive standarde, në mënyrë që të sigurojë parimin e uniformitetit.*

*Në këtë punim përshkruhet i tërë procesi i nevojshëm për të siguruar përkthim cilësor, proces i cili fillon që me njohjen e gjuhëve dhe përfundon me trajtimin e zgjidhjeve të problemeve më të rëndësishme dhe më të hasura përkthimore.*

*Punimi është një përpjekje për të analizuar e krahasuar zgjidhjet e problemeve të mundshme gjatë përkthimit nga gjuha angleze në gjuhën shqipe. Përgjithësisht është zbatuar metoda përmasë-krahasuese.*

*Rruga dhe metodologjia e përdorur për të mbledhur të dhënat për këtë studim janë të larmishme. Kështu, autorja ka përdorur metodën cilësore të kërkimit, pasi ky punim mbështetet tek të kuptuarit e “aftësive që i duhen një përkthyesi” për të qenë në gjendje të merret me përkthimin e teksteve të tilla aq delikate sa *acquis communautaire*. Për këtë arsye, autorja i është referuar kryesisht analizimit të literaturës më të fundit mbi përkthimin, përvojës së saj vetjake dhe përvojës së kolegëve të tjerë përkthyes. Po ashtu, është përdorur metoda sasiore për të analizuar përdorimin e saktë të terminologjisë, strukturave të teksteve në gjuhën burimore dhe problemet më të shpeshta në dokumentet e përkthyer. Puna me studentët ka luajtur po ashtu rol të madh për të kuptuar se cilat janë mangësitë e tyre kryesore përkundrejt aftësive që i duhen ekspertëve përkthyes për të qenë në gjendje të përkthejnë *acquis communautaire*.*

### ***Korpusi gjuhësor dhe kampionet e punimit***

*Për të bërë një studim diakronik mbi problemet përkthimore, janë përdorur tekste në gjuhën burimore, pra në gjuhën angleze, të marra kryesisht nga burime zyrtare të BE-së, të tilla si faqja e Komisionit Evropian, Parlamentit*

*Evropian, Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, dhe përkthime të certifikuar qoftë nga Bashkimi Evropian, ashtu edhe nga institucionet zyrtare të Shqipërisë.*

*Për të nxjerrë në pah ngjashmëritë dhe ndryshimet ndërmjet teksteve në gjuhën burimore dhe në gjuhën e synuar, autorja i është referuar fjalorëve të shumtë e të ndryshëm, të tilë si: Chambers, *Encyclopedic English Dictionary*, (1994) Chambers; *1st Ed; The New Shorter Oxford English Dictionary* (1998); *Fjalori i gjuhës shqipe*, (1954; 1980, 2002) *OXFORD Advanced Learners*, (2006) 2<sup>nd</sup> edition; *The Columbia Encyclopedia* (1993), Chambers – *Encyclopedic English Dictionary* (1994); *The New Shorter Oxford English Dictionary* (1998), *Black's Law Dictionary*, si në versionin online dhe në versionin e fjalorit tradicional, *Fjalorit të terminologjisë juridike anglisht – shqip, shqip - anglisht të Shefije Hasanit* (1998), *Fjalorit të termave juridike, ekonomike dhe biznesi anglisht-shqip (Dictionary of Law, Economy and Business English-Albanian)* të Luan Kacelit, (2002) dhe shumë e shumë dokumenteve të tjera.*

*Shembujt e përdorur në këtë punim janë marrë kryesisht nga dokumentet e përkthyer nga autorja dhe nga burime të tjera zyrtare. Përveçse kur tekstet në gjuhën e synuar janë përkthyer nga autorja, të gjitha tekstet e marra nga burime të tjera janë specifikuar në seksionet përkatëse të këtij punimi dhe për to është marrë leja paraprake e përkthyesve apo e institucioneve përkatëse.*

### ***Struktura dhe metoda e studimit***

*Punimi është i organizuar në shtatë kre:*

***Kreu i parë*** i punimit paraqet një kornizë të zhvillimeve, ecurisë dhe prirjeve të procesit të përkthimit të *acquis communautaire*, parë nga këndvështrimi i multilingualizmit dhe rëndësisë së tij. Ai analizon proceset që u është dashur të kalojnë shteteve më të përafërta me



*Shqipërinë teksa kanë trajtuar çështjet e përkthimit të acquis communautaire, e të cilat, me shumë të ngjarë, do të duhet të kalojnë dhe Shqipëria.*

*Kreu i dytë dhe i tretë marrin në shqyrtim gjuhën si bazë të procesit të përkthimit, dhe rëndësinë e pasjes dhe fitimit të aftësive për t'u bërë përkthyes.*

*Më specifikisht, **Kreu i dytë** përqendrohet tek kompetenca gjuhësore dhe tek aftësitë gjuhësore që duhet të ketë përkthyesi përpara se t'i futet procesit të përkthimit. Për këtë qëllim, në këtë pjesë autorja ka shqyrtuar si bazë Kuadrin e Përbashkët Evropian të Referencave për Gjuhët (CEFRL), i hartuar në fillim të viteve '90 nga Këshilli i Evropës, dhe Standardet e Nxënies së Gjuhëve të Huaja, botuar për herë të parë në vitin 1996 nga Këshilli Amerikan për Mësimin e Gjuhëve të Huaja (ACTFL). Në këtë pjesë argumentohet që për përkthyesit e acquis communautaire është i aplikueshëm vetëm niveli gjuhësor më i lartë i spektrit të dy kuadreve të përshkruara në këtë Kre, ose më specifikisht niveli C2 i Kuadrin të Përbashkët Evropian (CEF) dhe niveli i avancuar dhe i shkëlqyer i Standardeve të Nxënies së Gjuhëve të Huaja të Këshillit Amerikan për Mësimin e Gjuhëve të Huaja (ACTFL). Pra, në këtë kre përcaktohet pragu i nivelit gjuhësor që është i domosdoshëm për dikë përpara angazhimit në përkthime të tilla të specializuara si acquis communautaire.*

***Kreu i tretë** hulumton rëndësinë e aftësive në përkthim dhe përqendrohet tek eksperti përkthyes. Në të jepet një analizë e procesit të nevojshëm për të përfituar aftësitë dhe nënaftësitë e nevojshme për përkthyesit për të qenë në gjendje të bëjnë përkthime cilësore. Në përgjithësi, autorët që janë marrë me analizën e nivelit të ekspertizës bien dakord që njohuritë e ekspertëve në përkthim varen nga aftësitë ekzistuese: njohja shumë e mirë e gjuhës burimore dhe e gjuhës së synuar dhe e kulturave të lidhura me to, e shoqëruar me "njohuri të thelluara" në fushat për të cilat përkthehet dhe "njohuri të përgjithshme" për të qenë në gjendje që të bëhen*

sa më shumë lidhje (asociacione) të jetë e mundur dhe për të siguruar zgjidhje të problemeve përkthimore që mbështeten me argumente të mjaftueshme bindëse.

Po ashtu, studimet tregojnë se njohuritë në nivel eksperti, të kombinuara me "praktikën e qëllimshme" (Ericsson) dhe me motivimin (Moser), njihen si elementë kryesorë të një eksperti dhe i bëjnë atij të mundur të përballojë me më pak vështirësi situata të reja dhe stresuese. Ekspertiza i lejon përkthyesit të trajtojë me më efektivitet "të panjohurat", të tilla si fjalori, ekuivalenca gjuhësore, terminologjia, dhe të ketë më shumë lehtësi në zgjidhjen e problemeve përkthimore krahasuar me jo ekspertët.

**Kreu i katërt** trajton metodat e përkthimit dhe mënyrat e qasjes ndaj tij. Në të theksohet rëndësia e përcaktimit të llojit të tekstit objekt përkthimi, e zhanrit ose e nënzhanrit, e lexuesit të synuar dhe e mënyrës së formulimit të mesazhit. Kur merr përsipër përkthimin e një akti që është pjesë e *acquis communautaire*, përkthyesi duhet të jetë i vetëdijshëm për hapat që duhet të ndër marrë duke e konsideruar punën e përkthimit si zgjidhje problemi. Fillimisht përkthyesi duhet të analizojë llojin e tekstit. Nuk ka dyshim që kur flasim për *acquis communautaire* flasim për përkthime për qëllim specifik (përkundrejt përkthimit letrar), kështu që ajo çfarë përkthyesi duhet të bëjë si fillim është që të përcaktojë fushën e ngushtë të tekstit. Më pas është e rëndësishme që të përcaktohet se çfarë qëllimi ka teksti; a bëhet fjalë për një tekst specifik që i përket një fushe të ngushtë specializimi, si për shembull fushës bujqësore, fushës legislative, të drejtës së konkurrencës, etj., apo bëhet fjalë për një tekst të një natyre më të përgjithshme. Pasi e ka bërë këtë analizë përkthyesi është në gjendje të përzgjedhë metodën e duhur për t'ju qasur përkthimit të tekstit, duke pasur parasysh rregullat e përgjithshme të procesit të përkthimit, por duke i kushtuar rëndësi të posaçme tipareve të gjuhës ligjore.

*Kategoritë e veçanta të teksteve dhe gjuha e përdorur në to trajtohen në këtë pjesë të tekstit.*

*Pasi është folur më parë për nivelin e nevojshëm gjuhësor që i nevojitet përkthyesit para se të angazhohet në projekte përkthimore, aftësitë për t'u quajtur ekspert dhe qasjen ndaj përkthimit, në **Kreun e pestë** vijohet me shembuj praktikë të projekteve të përkthimit dhe me shpjegimet përkatëse të zgjidhjeve të sugjeruara. Ky kre fillon me trajtimin e elementëve më të vegjël në korpusin e legjislacionit të BE-së, pra me fjalët, vijon me fjalët teknike, terminologjinë, rëndësinë e njohjes së fushës në të cilën ofrohet përkthimi dhe me çështje të tjera të ngjashme. Vlera e shtuar e këtij kreu është se në të ofrohen zgjidhje për situata të caktuara dhe argumentime përkatëse për zgjidhjet në fjalë. Përveç ofrimit të disa zgjidhjeve të gatshme, ky kre ka për qëllim që t'i sugjerojë lexuesit mënyra sesi mund t'i trajtojnë tekstet e ndërlikuara, apo të vështira për t'u përkthyer.*

***Kreu i gjashtë** përqendrohet tek terminologjia, duke qenë se terminologjia është sfida më e madhe e përkthyesve që merren me *acquis communautaire*. Në të trajtohen aspekte teorike të përkthimit të terminologjisë si dhe trajtime të problemeve praktike që ngrihen lidhur me terminologjinë gjatë përkthimit.*

*Në **Kreun e shtatë** vijohet me të njëjtën analizë, por duke u përqendruar tek transpozimi, modulimi, përshtatja, elementët e sintaksës së gjuhës angleze dhe procesit të transpozimit të saj në shqip. Një seksion i veçantë në këtë kre i dedikohet rregullave të shkrimit në gjuhën shqipe. Edhe në këtë pjesë të punimit jepen shembuj dhe ilustrime të shumta për çështjet e trajtuara.*

*Më pas në punim vijohet me **rekomandime** dhe **përfundime** që vijnë si rezultate logjike të analizës së përfshirë në këtë punim dhe të përvojës së autores gjatë përkthimit të dokumenteve të shumta në volum dhe të larmishme në vështirësi në këtë fushë. Ato kanë për qëllim t'i*

*ndihmojnë si studentët e përkthimit në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja, ashtu dhe profesionistët e rinj për t'u bërë përkthyes premtues në të ardhmen. Është e rëndësishme të theksohet se krrerët janë formuluar me përfundimet përkatëse për secilën nga çështjet e trajtuara.*

*Përkthimi i dokumenteve të *acquis communautaire* karakterizohet nga një dualizëm i brendshëm: liri dhe kufizim. Liria ka të bëjë me përkthimin e pjesëve jo standarde, ndërsa pjesët standarde kanë përkthim të kufizuar. Kështu, në BE kur përkthehet një direktive, pjesët standarde janë të ngurtësuara dhe standarde, ndërsa përkthyesit merren me përkthimin e pjesëve jo standarde. Në fund, punimi përmban dhe një Shtojcë ku ofrohet një version për përkthimin e pjesëve të ngurtësuara të disa prej dokumenteve të *acquis communautaire*.*

*Ndonëse është shfrytëzuar literaturë e pasur për këtë punim, përfshirë edhe libra dhe artikuj shkencorë të botuar kohët e fundit, autorja është e mendimi se bibliografia nuk është shteruese pasi studimet dhe kërkimet për përkthimin e *acquis communautaire* janë një instrument gjithnjë e në zhvillim dhe janë të ndryshme në varësi të kombinimeve të ndryshme gjuhësore të përdorura.*

*Punimi është shkruar me një narrativë të thjeshtë dhe praktike në përpjekje për të lehtësuar procesin e të kuptuarit të problemeve të shumta dhe të ndërlikuara që dalin gjatë procesit të përkthimit. Ai trajton tipologji të ndryshme të problemeve përkthimore.*

### **Çfarë është *acquis communautaire* në dritën e këtij punimi**

Duke qenë se njëra ndër fjalët kyçe të këtij punimi është *acquis communautaire*, është e udhës që autorja të ndalohet pikë së pari tek kuptimi i termit dhe tek përkufizimi i tij për qëllime të këtij punimi. Termi *acquis communautaire*

është krijuar për t'iu drejtuar të gjitha akteve të Komunitetit të miratuara mbështetur në Traktatet e Romës dhe të gjitha vendimeve të marra që prej krijimit të Komuniteteve. *Acquis communautaire* është term në gjuhën frënge, i cili do të thotë “BE-ja siç është” (*EU as it is*). Me fjalë të tjera termi mishëron tërësinë e trupës së të drejtave dhe të detyrimeve që bashkojnë të gjitha shtetet anëtare të Bashkimit Evropian (BE). *Acquis communautaire* përfshin të gjitha traktatet, ligjet, deklaratat dhe rezolutat e BE-së, marrëveshjet ndërkombëtare lidhur me çështjet e BE-së dhe vendimet e marra nga Gjykata e Drejtësisë. Ndërsa shtetet anëtare e kanë *acquis communautaire* pjesë të rendit të tyre juridik dhe të funksionimit të shtetit, shtetet që aspirojnë të bëhen anëtare të BE-së duhet ta pranojnë *acquis*-in e Komunitetit përpara se të bëhen pjesë e Bashkimit, çfarë do të thotë që duhet ta pranojnë BE-në siç e gjejnë, apo siç është dhe ta bëjnë të drejtën e BE-së pjesë të së drejtës së tyre të brendshme. Por, puna për përkthimin dhe harmonizimin e *acquis communautaire* fillon shumë vite më parë sesa procesi i pranimit në familjen e madhe të BE-së. Ajo është e pranishme që në fazën e ngjizjes së idesë për anëtarësim në Bashkimin Evropian.

Kështu, në rastin e Shqipërisë, puna për përkthimin e *acquis communautaire* ka filluar, pasi deri tani janë përkthyer pyetjet e pyetësorit të Komisionit Evropian për analizimin e situatës së Shqipërisë përpara nënshkrimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit, shumë rregullore, direktiva, vendime, opinione, rekomandime të BE-së dhe disa vendime me peshë të jurisprudencës së Gjykatës së Luksemburgut, si dhe disa rregullore, vendime dhe opinione të BE-së që janë të rëndësishme për legjislacionin e brendshëm të vendit. Por, sipas përvojës së shteteve të tjera që e kanë bërë përpara Shqipërisë këtë ushtrim, qoftë në rajon dhe më gjerë, puna e vërtetë për përkthimin e *acquis communautaire* ende nuk ka filluar. Vlerësimet e përafërta flasin për mbi 180,000 faqe

dokumentacion për t'u përkthyer nga momenti i hapjes së negociatave me Shqipërinë dhe deri në anëtarësim. Gjatë kësaj periudhe *acquis*-i ndahet në kapituj të cilët negociohen ndërmjet BE-së dhe shteteve kandidatë.

Nën dritën e këtij punimi, *acquis communautaire* i referohet të gjithë tërësisë së normave juridike që e përbëjnë atë, pra përfshin direktivat, rregulloret, opinionet, vendimet e gjykatave, pjesë nga të cilat do të përdoren gjatë të gjithë punimit për qëllime ilustrimi. Ndërkohë që është e pamundur të trajtohen të gjitha karakteristikat e përkthimit për të gjitha këto instrumente, ky punim do të përqendrohet në procesin e përkthimit si zgjidhje problemi<sup>1</sup> duke e parë përkthimin si proces, dhe duke u ndalur në “zërat” kryesorë të tij.

Ndërkohë, termi i dytë kyç në këtë punim është *përkthimi*. Siç dihet nga të gjithë, për qëllime të traduktologjisë<sup>2</sup>, procesi i përkthimit përfshin të paktën dy gjuhë, gjuhën e nënës dhe gjuhën e huaj nga e cila ose drejt së cilës përkthehet. Në terminologjinë e përkthimit këto gjuhë njihen si gjuha burimore<sup>3</sup> (GjB) dhe gjuha e synuar (GjS). Në Shqipëri, në ato pak studime që ekzistojnë rreth fushës së përkthimit, termat *source language* dhe *target language* përkthehen në forma të ndryshme. Është me vend të theksohet se literatura e huaj dhe ajo pak literaturë ekzistuese në shqip i lidhin konceptet e gjuhës burimore dhe gjuhës së synuar vetëm me gjuhën e materialit bazë të përdorur si objekt përkthimi dhe të produktit që realizohet pas procesit të përkthimit, duke mos i veshur këto koncepte me karakteristika të tjera dalluese të rëndësishme për procesin e përkthimit, të

---

<sup>1</sup> Përkthimi si problem për zgjidhje.

<sup>2</sup> Ndërkohë që ne përkthejmë dhe interpretojmë brenda së njëjtës gjuhë gjatë të gjithë kohës, për qëllime të fushës së përkthimit, procesi i përkthimit kërkon të paktën dy gjuhë.

<sup>3</sup> Në disa tekste në gjuhën shqipe përdoren termat Gjuha Origjinale (GJO) dhe Gjuha Vendore (GJV). Shih [www.mie.gov.al](http://www.mie.gov.al); termat gjegjës të përdorur në këtë punim janë gjuha burimore (GjB) dhe gjuha e synuar (GjS).

tilla si nocioni i gjuhës amtare, bilingualizmi, gjuha e huaj, përkthimi nga një gjuhë e huaj (e dytë) më pak e njohur nga përkthyesi, etj. Pra me fjalë të tjera, gjuha amtare mund ta gjejë veten edhe në pozicionin e gjuhës burimore dhe në pozicionin e gjuhës së synuar. E njëjta logjikë përdoret dhe për gjuhën e huaj, pavarësisht nëse ajo është gjuhë e parë ose e dytë e nxënë.

Për shkak se ky punim përqendrohet tek procesi i përkthimit në shqip të *acquis communautaire*, kemi një gjuhë burimore të përcaktuar, që për qëllime të këtij punimi është gjuha angleze, dhe një gjuhë të synuar po ashtu të përcaktuar, e cila është gjuha shqipe. Autorja është e mendimit që nën dritën e këtij punimi duhet të bëhet një specifikim i mëtejshëm i karakteristikave të gjuhës burimore dhe gjuhës së synuar, për të pasur më shumë mundësi për të trajtuar më mirë për qëllime përkthimi pikat e dobëta dhe pikat e forta të secilës gjuhë dhe për të qenë në gjendje të punohet në vijimësi me gjuhët, gjë që përbën parakusht për përkthimin.

Për të përcaktuar këto karakteristika, për shkak të njohjes dhe eksperiencës së saj në interpretim, autorja i është drejtuar fushës së interpretimit, një disiplinë e mëvetësishme por “e lidhur”, e quajtur ndryshe si “fqinje” me përkthimin. Në fushën e interpretimit bëhet ndarja e gjuhëve në gjuhë A, në gjuhë B<sup>4</sup> dhe në gjuhë C. Për analogji të objektit të punimit, ne jemi të interesuar të dimë karakteristikat e gjuhës A, që në rastin e përkthimit të *acquis communautaire*, objekt i këtij studimi, është gjuha shqipe, dhe të gjuhës B dhe C<sup>5</sup>, që në rastin në fjalë është gjuha angleze mbështetur në të cilën bëhet përkthimi në gjuhën shqipe. Analogjia e gjuhës angleze me gjuhën B dhe C në këtë punim lidhet me nivelin e njohjes

---

<sup>4</sup> Ndërsa në përkthim njihet GjB-ja dhe GjS-ja, në interpretim përveç gjuhës A dhe gjuhës B njihet dhe Gjuha C.

<sup>5</sup> Lexo më poshtë për më shumë informacion rreth nocioneve të gjuhës A, B dhe C.

së gjuhës angleze si gjuhë të huaj. Më specifikisht, për punimin në fjalë gjuha e synuar është *gjuha amtare* dhe gjuha burimore është *gjuhë e huaj*<sup>6</sup>. Autorja është e bindur që është e nevojshme që të bëhet ky dallim që në fillim të punimit, për shkak se pavarësisht nga njohja e mirë apo shumë e mirë e një ose disa gjuhëve të huaja, studimet empirike dhe përvoja si përkthyes na tregojnë kokëfortësisht se ne jemi, në rastin më të mirë, njohës shumë të mirë të gjuhës amtare dhe njohës të mirë ose rrallë shumë të mirë të gjuhës së huaj.

Mbështetur në përkufizimet e gjuhës A, B dhe C nga Shoqata Ndërkombëtare e Interpretëve të Konferencave<sup>7</sup> (e cila njihet zakonisht me akronimin e saj në gjuhën frënge, *AIIC*) propozohet sistemi i mëposhtëm i klasifikimit gjuhësor:

### **Gjuhë aktive**

**A:** gjuha e nënës e interpretit (ose një gjuhë tjetër e cila është absolutisht ekuivalente me gjuhën e nënës), drejt së cilës interpreti përkthen nga të gjitha gjuhët e tjera të tij të punës, në të dyja mënyrat e interpretimit, në interpretimin simultan dhe në atë konsektiv. Të gjithë anëtarët e AIIC-ut duhet të kenë të paktën një gjuhë 'A', por mund të kenë dhe më shumë se një gjuhë 'A'.

**B:** është gjuha e ndryshme nga gjuha e nënës e interpretit, të cilën ai e zotëron në mënyrë të shkëlqyer dhe drejt së cilës ai punon bazuar në një ose më shumë gjuhë të tjera pune. Disa interpretë punojnë në gjuhën 'B' në vetëm në një mënyrë interpretimi (simultan ose konsektiv), ose në të dyja mënyrat e interpretimit.

---

<sup>6</sup> Siç do të shihet dhe në kretë pasardhës, është e rëndësishme që të përcaktohet statusi i gjuhës B si gjuhë e huaj për arsye të të nxënimit të saj.

<sup>7</sup> International Association of Conference Interpreters; [www.aiic.net](http://www.aiic.net).



### **Gjuhët pasive**

C: Gjuhët për të cilat interpreti ka kuptim të plotë dhe nga të cilat ai punon.

Këto përkufizime jepen në përpjekje për të prekur koncepte të cilat nuk janë plotësisht të qarta. Nëse një interpret ka folur dy gjuhë që prej fëmijërisë, mund të thuhet se të dyja gjuhët e folura janë gjuhë të nënës. Nga ana tjetër, nëse i njëjti person ka kaluar shumë vite të jetës së tij jashtë shteti, ai mund të konsiderohet se ka njohuri shumë të mira të të dyja gjuhëve sikur t'i kishte të dyja gjuhë të nënës. Grosjean-i (1998) shprehet se niveli i rrjedhshmërisë dhe i njohjes së thelluar të të dy gjuhëve ndryshon tek i njëjti individ, në varësi të kontekstit ku ai e përdor secilën nga gjuhët dhe nga fakti nëse ai komunikon me persona që flasin një gjuhë, apo të njëjtat (dy) gjuhë si edhe ai. Një gjuhë 'B' në fakt mund të jetë një gjuhë e dytë "amtare" nëse interpreti është rritur në një mjedis gjuhësor ku flitet kjo gjuhë. Në rast se gjuha "B" është gjuhë e fituar si rezultat i kalimit të shumë kohe jashtë shteti, thellimi në gjuhën "e fituar" konsiderohet të jetë pak më i vogël (Guichot De Fortis, 2010) sesa në gjuhën amtare. Shpesh dallimi ndërmjet gjuhës 'A' dhe 'B' arrin një pikë të vdekur kur bëhen pyetjet e mëposhtme: Çfarë nënkuptohet me "njohuri të shkëlqyer" të gjuhës? A mund të pritet njohje e shkëlqyer e gjuhës së nënës nga çdo folës i gjuhës amtare?

Adams (2002) përpiqet ta rafinojë përkufizimin AIIC-ut, duke e përshtetur gjuhën 'B' si:

"gjuha në të cilën mund të mendoni në mënyrë formale dhe të strukturuar (për shembull, në një situatë përkthimi);

gjuha në të cilën mund të jepni një mesazh të qartë dhe të saktë për pjesëmarrësit në konferencë, kolegët që marrin përkthimin nga ju dhe kolegët që kanë të njëjtën gjuhë "A" me ju. Pra, me fjalë të tjera, na duhet ca më shumë sesa vetëm 'komandë të shkëlqyer' (Adams, 2002:20) për të qenë në gjendje të kategorizojmë një gjuhë si gjuhë "B".

Mbështetur në analizën e mësipërme, është e qartë që baza e punës së përkthyesit të *acquis communautaire* është gjuha shqipe, në cilësinë e saj si gjuhë të synuar dhe në pozicionin e gjuhës amtare, gjuhë në të cilën, pa dyshim, ne shprehemi më mirë. Megjithatë, për qëllime të këtij punimi, karakteristikat e gjuhës "B" në interpretim i përkojnë më mirë gjuhës burimore, pra anglishtes. Mbështetur në analizën e mësipërme është e qartë që megjithëse në pozicionin e gjuhës së huaj, gjuha angleze duhet të njihet shumë mirë dhe duhet të jetë thuajse në të njëjtin nivel ashtu si edhe gjuha amtare për të qenë në gjendje që të prodhohet një përkthim sa më dinjitoz dhe i saktë.

Pas kësaj analize të këtyre termave kyç të këtij punimi, është e udhës të sqarohet se qëllimi kryesor i këtij punimi është: a) të nënvizojë nevojën e madhe për ekspertë përkthyes për përkthimin e *acquis communautaire*; b) të ofrojë zgjidhje të problemeve përkthimore, duke e parë përkthimin si zgjidhje problemi nëpërmjet shembujve të marra nga praktika; c) të japë arsyet pse është e nevojshme që përkthimi të konsiderohet si proces i specializuar, që kërkon aftësi dhe njohuri të posaçme; dhe d) të japë disa rekomandime për studentët e përkthimit dhe përkthyesit e rinj lidhur me mënyrën sesi ata mund ta menaxhojnë më mirë procesin e përkthimit.

Pavarësisht nga ky punim, i hartuar mbi përkthimin e *acquis communautaire*, duhet theksuar se vlera dhe rëndësia jetike e trajnimit formal në fushën e traduktologjisë, posaçërisht në nivelin universitar, është shumë e rëndësishme

dhe është e mbuluar gjerësisht nga literatura e fushës. Gonzalez, Vasquez dhe Mikkelson (2012:103) argumentojnë se programet e rregullta arsimore japin “siguri për ofrimin e një shërbimi kompetent dhe etik” dhe “çojnë në një hap më tej drejt konsolidimit të identitetit si disiplinë profesionale e specializuar.”

Arsimi në fushën e traduktologjisë në Shqipëri është larg përshkrimeve të programeve të mirëfillta të përkthimit në letërsinë bashkëkohore, dhe jo i aftë t’i përgatisë studentët të integrohen në tregun e punës pas përfundimit të studimeve. Programi i Masterit për Përkthimin Teknik dhe Letrar dhe Interpretimin i Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës, mund të përshkruhet pa hezitim si programi më i mirë deri tani i dedikuar për fushën e përkthimit dhe interpretimit, por ai ka natyrën e një programi të kombinuar gjeneralist që nuk i pajis studentët me aftësitë dhe me njohuritë e nevojshme për të qenë në gjendje të punojnë në një treg me rregulla të papërcaktuara, ku kërkohet gjithnjë e më tepër cilësi, kryesisht lidhur me fusha të ngushta ekspertize dhe jo me aspekte puro gjuhësore.

### **Niveli i gjuhës së huaj**

Një studim më i ngushtë mbi gjuhët e përdorura për përkthimin, mësimdhënien dhe vlerësimin e gjuhëve të huaja, si dhe përpunimi gjuhësor i gjuhëve prej nesh, na ndihmon të identifikojmë shumë sfida që mbeten ende për t’u zgjidhur përpara se të fillohet procesi i përkthimit.

Kuadret ekzistuese për gjuhët e huaja bëjnë dallimin ndërmjet niveleve të ndryshme të zotërimit të gjuhëve dhe i lidhin ato me nënaftësitë gjuhësore të cilat përkufizohen gjerë dhe qartë, por që do të duhen të shtjellohen më tej në rastin e përkthimit. Një ndër avantazhet kryesore të këtyre kuadreve është që ato përditësohen dhe përmirësohen rregullisht për të

përfshirë aspekte të reja të të nxënit të gjuhëve dhe për të ofruar një instrument edhe më të mirë për vlerësimin e kompetencës së gjuhës së huaj. Për përkthyesit e fushave të tilla specifike si përkthyesit e *acquis communautaire* është i aplikueshëm vetëm niveli më i lartë i spektrit të dy kuadreve të përshkuara në këtë Kre, ose më specifikisht niveli C2 i Kuadrit të Përbashkët Evropian (CEF) dhe niveli i *avancuar* dhe i *shkëlqyeshëm* sipas kuadrit të ACTFL-së. Megjithatë, meqenëse niveli C2 i CEF-së është më i përgjithshëm dhe mund t'i referohet një gjuhe të huaj të tretë, pasi niveli i kompetencës që kërkohet nga përkthyesi në gjuhën amtare ose në gjuhën e huaj është shumë i lartë për t'u trajtuar nga niveli C2, duket se për përkthyesit janë më të përshtatshme nivelet e larta të kuadrit të ACTFL-së. Ato janë zgjeruar më tej kohët e fundit për të përfshirë dhe aftësitë gjuhësore të ekspertit (gjuhësor), të cilat janë shumë pranë aftësive gjuhësore që priten në mënyrë të arsyeshme nga folësit, dëgjuesit, lexuesit dhe shkruarit e gjuhës amtare.

Analiza e shkurtër e disa studimeve neurologjike për bilingualizmin dhe mësimin/përvetësimin e gjuhëve dëshmon se, megjithëse shumë çështje lidhur me ngjashmëritë dhe dallimet që kanë të bëjnë me mënyrën e organizimit në tru të gjuhës së parë ose të gjuhës së dytë mbeten ende pa përgjigje, përpunimi gjuhësor për gjuhën e parë dhe për gjuhën e dytë nuk është domosdoshmërisht tërësish i ndryshëm, por ndryshon në varësi të nivelit të përvetësimit të gjuhës. Ky shpjegim dhe struktura e kuadreve të referencës duket se sugjerojnë se është e mundur të përmirësohet performanca në secilën prej gjuhëve.

### **Paradigma ndërmjet përkthyesit jo ekspert dhe përkthyesit ekspert<sup>8</sup>**

Trajnimi në çdo fushë specifike kërkon pikësëpari përkufizimin e qartë të nivelit të ekspertit, pra përcaktimin e aftësive, të kapacitetit, të performancës, të etikës e të normave të tjera të nevojshme për dikë për t'u quajtur ekspert në një fushë të caktuar, pasi arritja e nivelit të ekspertit përbën objektivin që duhet të synohet të arrihet nga profesionistët e të gjitha fushave<sup>9</sup>. Po ashtu arritja e nivelit të ekspertit

---

<sup>8</sup> Për qëllimin e këtij studimi në kuadrin e ekspertizës autorja i është drejtuar vetëm kategorisë së jo ekspertëve dhe ekspertëve.

<sup>9</sup> Është e kuptueshme që në literaturë nuk bëhet direkt kalimi nga një person jo ekspert tek eksperti. Më specifikisht, Hoffman, lidhur me ekspertizën njih nivelet e mëposhtme:

“*i paditur*”, i cili përkufizohet si dikush që nuk ka fare njohuri për fushën. Arsyeja pse Hoffman-i e fillon progresionin zhvillimor me këtë kategori, është se në shumë studime të botuara, të ashtuquajturit “fillestarë” janë në fakt “të paditur”;

“*fillestari*” është dikush që është i ri, dikush që është në përvojë, ose për shembull, dikush që do të fillojë studimet në interpretim/përkthim. Dallimi ndërmjet “të paditurit” dhe “fillestarit” është që fillestari është ekspozuar minimalisht me fushën e studimit, ose është prezantuar me të;

Më pas vjen “*nxënësi/stazhieri*”, personi që është duke iu nënshtruar procesit të të nxënimit, si për shembull një student që i nënshtrohet një programi udhëzimesh, shkon përtej nivelit të prezantimit dhe është gati për të kaluar në nivelin tjetër;

“*specialisti*” është personi i cili mund të kryejë punën e përditshme në mënyrë kompetente, pa qenë e nevojshme për t'u mbikëqyrur, por që punon bazuar në udhëzimet e marra; ai është punonjës me përvojë dhe i besuar;

“*eksperti*” është specialisti gjykimet e të cilit janë në mënyrë të spikatur të sakta dhe të besueshme, performanca e të cilit dëshmon për aftësi të larta dhe përpjekje jo të sforcuara dhe që mund të trajtojë në mënyrë efektive lloje të caktuara problemesh të rralla apo të vështira. Po ashtu, eksperti ka aftësi apo njohuri të posaçme që rrjedhin nga përvoja e gjerë ose e përqendruar në nënfusha;

Në nivelin më të lartë është “*mjeshtri*”, ekspert i kualifikuar dhe i aftë për të mësuar të tjerët. Tradicionalisht mjeshttrat përbëjnë grupin e elitës, gjykimet

shoqërohet me më shumë njohuri të thelluara mbi fushën e ekspertizës. Sipas së njëjtës logjikë, është e nevojshme që të përkufizohet niveli i ekspertit<sup>10</sup> përkthyes në mënyrë që për arsye trajnimi, ai të shërbejë si niveli i synuar për t'u arritur nga palët e interesuara, si për shembull, studentët e përkthimit, personat që kanë vendosur t'i dedikohen përkthimit, personat që po shqyrtojnë mundësinë e kapërcimit nga një fushë tjetër e afërt a e lidhur ekspertize me përkthimin, personat që kanë përkthyer më parë, por që nuk janë shumë të afirmuar në treg, ose që dëshirojnë të rrisin aftësitë kognitive dhe teknike në fushën e përkthimit, apo çdokush tjetër i interesuar për studime empirike në fushën e përkthimit.

Studimet rreth ekspertizës e kanë zanafillën nga kërkimet klasike të De Groot-it (1965, 1966) e shoqërohen nga të tjerë pas tij, të interesuar për të zbuluar dasinë ndërmjet aftësive të shahistëve. De Groot-i (1965) më shumë se gjysmë shekulli më parë konstatoi se teksta nuk kishte dallime të mëdha ndërmjet gjerësisë apo thellësisë së kërkimeve lidhur me lëvizjet e mundshme gjatë lëvizjeve të gurëve të shahut, ekspertët i perceptonin ndryshe problemet që duhet të zgjidhnin. Një tjetër kërkim pionier mbi fushën e ekspertëve dhe të ekspertizës ka të bëjë me qasjet e jo ekspertëve dhe të ekspertëve për të zgjidhur probleme fizike, kryer nga Simon-i dhe Simon-i (1978) dhe Larkin-i, Dcdemott-i, et al. (1980a, 1980b). Sipas studimeve të tyre, ekspertët dhe jo ekspertët ndryshonin në mënyra të ndryshme: ekspertët ishin në gjendje t'i dilnin përpara problemit dhe të përdornin faktet që kishin për të gjeneruar ekuacionet e përdorura. Ata i zgjidhnin më shpejt problemet dhe me gjasa krijonin një përfytyrim fizik të tyre.

---

e të cilëve përcaktojnë rregullat, procedurat, standardet ose idealet (Hoffman : 199).

<sup>10</sup> Më vonë në tekst fjala ekspert i referohet ekspertëve përkthyes.

Megjithëse në pamje të parë paragrafi i mësipërm duket si pak ose aspak i lidhur me fushën e përkthimit, logjika e nocionit të ekspertizës dhe të ekspertit është e njëjtë dhe në rastin e përkthimit dhe të interpretimit, madje dhe në çdo fushë tjetër. Studimet empirike tregojnë se ekspertët asociohen me të kuptuarin deri në detaje, për aq sa është e mundur, të njohurive, të arsytimit dhe zotërimin e aftësive të thelluara në fusha të ndryshme, me zhvillimin e instrumenteve metodologjike për t'i përfutur njohuritë e nevojshme dhe me përshkrimin e ngjashmërive ndërmjet ekspertëve të fushave të ndryshme (Moser-Mercer et al: 108). Künzl-i dhe Moser-Mercer-i (1995), në kuadrin e studimeve të tyre empirike mbi proceset e interpretimit dhe mbi *sight translation*<sup>11</sup> (Moser-Mercer, 1997, në shtyp) shprehen që baza e njohurive të përkthyesve ekspertë duket se është disi ndryshe e organizuar.

Ashtu si dhe në fusha të tjera, zhvillimi i ekspertizës në fushën e përkthimit kërkon integrimin e shumë nënaftësive dhe nënproceseve të përpunimit gjuhësor, një pjesë e të cilave ndodhin dhe paralelisht, si për shembull proceset e të kuptuarit të gjuhës, proceset sintaksore dhe semantike (Marsen-Wilson dhe Taylor 1980), duke vënë në punë dy sisteme gjuhësore në të njëjtën kohë, pra gjuhën burimore dhe gjuhën e synuar (Paradis 1993), dhe prodhimin gjuhësor, pra përpunimin sintaksor dhe semantik, përfshirë dhe dekodimin gramatikor dhe fonologjik (Levelt 1989). Megjithëse jo aq i ngjeshur sa procesi i interpretimit, përkthimi është proces i lodhshëm dhe shumë kërkuar, përfshin kombinimin e shumë nënaftësive, përdorimin e teknikave dhe të strategjive, të cilat duhet të mësohen si të tilla për të rritur gjasat për t'u bërë ekspert.

Nën optikën e argumentit të sipërpërmendur, personat e interesuar për t'u bërë profesionistë, apo për të studiuar më

---

<sup>11</sup> Koncepti i *sight translation* i referohet procesit të përkthimit ndërkohë që njëkohësisht e lexon një tekst që e ke fizikisht përpara.

shumë në fushën e përkthimit duhet të kuptojnë fillimisht natyrën e ekspertizës dhe mënyrën sesi përvetësohen apo nxihen aftësitë për të qenë në gjendje të arrihet niveli i ekspertit. Kërkimet në fushën e përvetësimit ose nxënies së aftësive janë përqendruar në fusha ku ekspertiza dhe performanca e lartë konsiderohen si rezultante të të nxënit dhe të praktikës. Kërkuesit kanë hulumtuar ekspertizën në fusha të tilla si sporte, arte, shkenca dhe në fusha të tjera kognitive, duke përfshirë dhe përkthimin dhe interpretimin.

Megjithëse me prejardhje të ndryshme, Hoffman-i (1997), Moser-i, Frauenfelder-i, Casado dhe Kunzl-i (2000), Ericsson-i (2001) dhe Moser-i (2008) të gjithë shqyrtojnë procesin e përfutimit të aftësive kryesisht në fushën e interpretimit, por edhe të përkthimit, dhe identifikojnë faza të nxënies së aftësive si mjet për akumulimin e njohurive prej eksperti.

Aftësitë kryesore të një eksperti përkthyes janë: të qenët analitik, të menduarit kritik, të lexuarit ndërmjet rreshtave, zotërimi i mjeteve gjuhësore të nevojshme për t'u shprehur saktë dhe drejt në secilën nga gjuhët e punës, mundësia për të kuptuar zhargonin dhe terminologjinë e përdorur në tekstin në gjuhën burimore dhe në gjuhën e synuar, etj.

### **Implikimet për përkthimin dhe trajnimin e përkthyesve**

Për sa i përket trajnimit të studentëve të përkthimit, përkthyesve të rinj në moshë a në profesion, është e rëndësishme të përdoret një qasje që e çon studentin/profesionistin e ri nga faza kognitive, tek ajo asociative dhe më pas autonome, nëpërmjet të cilave mësohen faktet rreth profesionit, detyrës apo projektit të përkthimit dhe procesit që duhet kaluar për të përfunduar projektin. Është e



rëndësishme që studentët a përkthyesit e rinj paralelisht me teorinë mbi traduktologjinë, të përballen gjithnjë e më shpesh me praktikën e përkthimit, të jenë në gjendje të analizojnë gabimet e tyre, të mësojnë t'i eliminojnë ato, të ndërtojnë kapacitetet për të bërë lidhjen ndërmjet pjesëve të ndryshme të procesit dhe të analizojnë sesi këto pjesë të ndryshme kontribuojnë për një punë të suksesshme, të përvetësojnë të gjitha procedurat e përkthimit nëpërmjet një trajnimit të qëndrueshëm dhe praktik aq sa procesi dhe puna e të përkthyerit t'u vijë natyrshëm dhe të dinë si të kërkojnë, si të hulumtojnë, kujt t'i drejtohen për probleme a dilema të ndryshme, dhe si t'u gjejnë zgjidhje problemeve që mund t'u dalin në praktikë.

Për ta ngritur një aftësi të fituar rishtazi në nivelin e ekspertizës, është e nevojshme që praktika e qëllimshme dhe analitike të bëhet pjesë e rutinës së studentëve apo e përkthyesve të rinj. Kjo është mënyra e vetme që bën të mundur eliminimin e pikave të dobëta, aplikimin e rregullave specifike për probleme specifike, dhe pas rritjes së njohurive taktike dhe organizimit më të mirë të tyre, edhe ndërtimin e strategjive për zgjedhjen e problemeve të hasura.

Po ashtu, mënyra sesi praktikohet studenti apo përkthyesi i ri, ka ndikim shumë cilësor mbi ekspertizën. Për t'u bërë ekspert me aftësi për t'iu përshtatur problemeve që mund të shfaqen, për të qenë në gjendje për të reflektuar mbi strategjitë tuaja dhe për të modifikuar çfarë është e nevojshme për t'u përshtatur me një situatë të re (interpretimi) (Moser-Mercer et al, 2000, Moser-Mercer, 2008), është e rëndësishme që studentët të mos praktikohen pa pasur objektiva të qarta. Në fakt ata duhet t'i ndajnë veprimet e ndryshme në aftësi të caktuara, procedurën dhe mënyrën e të funksionuarit të të cilave ata e kuptojnë qartë. Ata duhet të përqendrohen dhe të punojnë në mënyrë të ndërgjegjshme për përvetësimin e këtyre aftësive. Ky është parimi i praktikës së qëllimshme. Në mënyrë që studentët të jenë në gjendje të bëjnë përparime në

këtë drejtim, trajnimi duhet ta vërë theksin tek të nxënit metakognitiv, organizimi efektiv i njohurive dhe situata komplementare në të cilat fitohen aftësitë e caktuara (Moser-Mercer, 2008).

Po ashtu, është e rëndësishme të nënvizohet se pavarësisht nga orët e praktikës dhe nga eksperiencia, për shkak të vështirësisë së fitimit të aftësive të një niveli goxha të lartë, i tillë si përkthimi i *acquis communautaire*, duhet të kuptohet nga të gjithë nevoja për të kuptuar se çfarë ndikimi të madh ka motivimi, praktika e rregullt dhe me objektivat e qarta, të nxënit nga praktika dhe gabimet për përmirësimin e performancës dhe për përparimin drejt rrugës së ekspertizës.

Duke marrë parasysh aftësitë që nevojiten për t'u bërë ekspert, duke u përqendruar tek përkthimi i *acquis communautaire*, pjesët e mëposhtme të punimit japin një trajtim praktik të çështjeve të përkthimit, zgjidhjes së problemeve të përkthimit, në përpjekje për t'ju ardhur në ndihmë si studentëve dhe përkthyesve të rinj për të rritur njohuritë, për të kuptuar më mirë procesin e përkthimit dhe për t'i ndihmuar sadopak ata që të bëhen autonomë. Qëllimi i pjesëve të mëposhtme nuk është t'i japë një zgjidhje shteruese të gjitha çështjeve dhe problemeve të përkthimit, pasi një gjë e tillë do të ishte e pamundur dhe jorealiste, por t'i vijë në ndihmë subjekteve të sipërpërmendur të dinë si të mësojnë e të kenë ca piketa ku mund të mbështeten për t'i dhënë zgjidhje problemeve të përkthimit.

### **Eurozhargoni**

Një tipar i veçantë i sistemit ligjor të BE-së është i ashtuquajtur i eurozhargonit. Emërtimi ka ardhur për faktin se e drejta e Bashkimit Evropian përfshin shumë terma ligjore dhe nocione që janë shumë specifike e që kanë kuptim të ndryshëm nga kuptimi që mbartin në të drejtën e brendshme. Formulimi i dokumenteve ligjore të BE-së mund të jetë i

ndërlikuar dhe i vështirë për t'u kuptuar nga publiku i gjerë, por edhe nga ata që janë më të rrahur dhe më të njohur me legjislacionin e BE-së. Kjo vështirësi është më e dukshme tek gazetarët, veçanërisht tek gazetarët që vijnë nga shtetet kandidatë, ose nga vende që negociojnë për MSA-në. Kjo është arsyeja pse Bashkimi Evropian ka një faqe të dedikuar interneti ku shpjegohen me një gjuhë të qartë e të thjeshtë eurozhargonet<sup>12</sup>.

Edhe për përkthyesit eurozhargoni, apo gjuha e Bashkimit Evropian përbën një sfidë të madhe. Si çdo lloj tjetër zhargoni, eurozhargoni ka karakteristikat e veta, si shumëllojshmëri emrash, neologjizmash dhe shkurtimesh të synuara për shprehur konceptet europiane, të cilat nuk janë të pranishme në nivelin kombëtar. Përkthyesve u duhet të jenë të përditësuar me procesin dinamik të integrimit evropian dhe të lehtësojnë ndërveprimin ndërmjet shteteve, qeverive, zyrtarëve të lartë të BE-së dhe qytetarëve të thjeshtë. Duke qenë se procesi i integrimit evropian është gjithnjë në zhvillim e sipër, zyrtarët e BE-së flasin për politika, strategji dhe axhenda të reja, të cilat duhet të përkthehen në të gjitha gjuhët zyrtare të BE-së dhe pjesërisht dhe në gjuhët e vendeve që aspirojnë të bëhen pjesë e BE-së duke shkaktuar fluks novacionesh leksikore.

Në literaturën për eurozhargonin numërohen shumë tipare karakteristike për të, si për shembull, eurozhargoni përdor shumë terma të reja, të cilat ose janë tërësisht fjalë të reja, ose neologjizma semantikë; shumë terma të BE-së janë fjalë të përbëra; emrat e institucioneve ose programeve të ndryshme të BE-së jepen në formë të shkurtuar, ose me akronime; tekstet e BE-së janë të pasura me metafora dhe me metonimi. Megjithatë, për përkthyesit problemin kryesor e paraqesin kryesisht terminologjitë e reja. Shumë terma të përdorura në BE janë tërësisht fjalë të reja, si për shembull

---

<sup>12</sup> [http://europa.eu.int/abc/eurojargon/index\\_en.htm](http://europa.eu.int/abc/eurojargon/index_en.htm)

*comitology, communitisation, co-decision, eurotariff, flexicurity*, ose neologjizma semantike, pra terma që fitojnë kuptim të ri dhe semantik, të tilla si *cohesion* dhe *subsidiarity*, kuptimi i të cilëve është i vështirë dhe për përkthyesit e BE-së (Wagner : 1999). Edhe kompozitat ose fjalët e përbëra janë të zakonshme në gjuhën e BE-së. Përkthimet e eurozharoneve në shqip janë fjalë të huazuara dhe kalke nga gjuhë të tjera, kryesisht nga anglishtja.

Eurozhargonet, që janë kuptimet specifike dhe autonome të disa termave në të drejtën e BE-së, paraqesin sfidë të veçantë për përkthyesit. Kjo është arsyeja pse është shumë e rëndësishme për ata që punojnë me përkthimin e dokumenteve të BE-së të kenë njohuri të thelluar të objektit të dokumentit në gjuhën burimore.

Pavarësisht nga fakti që çdo qeveri ka gjuhën e vet të veçantë ose zhargonin e saj, Bashkimi Evropian është organizimi më i veçantë në zhvillimin e terminologjisë së tij unike. Ai ka tri forma “kodesh” të cilat janë shumë të rëndësishme dhe të përhapura: *akronimet, emrat e vendeve* dhe *numrat*.

Pas disa vitesh përvojë, përkthyesit njihen me zhargonin e zakonshëm të BE-së, por në fillim të punës së tyre si përkthyes për ta është shumë e vështirë të deshifrojnë me lehtësi një akronim të përdorur nga burokracia e BE-së. Nga ana tjetër, BE-ja i vendos të gjithë akronimet nëpërmjet një mekanizmi gjuhësor të vështirë për t’u deshifruar, shpesh duke përdorur akronime në anglisht në dokumente që janë në gjuhën frënge dhe anasjelltas. Për shembull, organi më i rëndësishëm vendimmarrës në Bruksel është COREPER-i (le Comité des Représentants Permanents – Komiteti i Përfaqësuesve të Përhershëm), ku “përfaqësuesit e përhershëm” (ambasadorët e vendeve anëtare të BE-së) “konfrontohen” për çështje të nxehta politike dhe ligjore. Dikush mund të argumentojë se problemi i akronimeve është pasojë e pashmangshme e mjedisit shumëgjuhësh të BE-së.

Por në qoftë se do të vëzhgohet më me hollësi, dyshimet rriten dhe shpesh arrihet në përfundimin se çdo konfuzion është në pjesën më të madhe të rasteve i qëllimshëm. COREPER-i është i ndarë në dy grupe, COREPER 1 dhe COREPER 2. Natyrisht, mendimi i parë që të shkon në mendje është që COREPER 1 qëndron më lart në hierarki se COREPER 2 dhe është, për pasojë, organi më i rëndësishëm. Por, në fakt nuk është kështu. COREPER 2 është vendi ku takohen ambasadorët, ndërsa COREPER 1 është vetëm për zëvendësit e tyre.

Një nga zakonet më të theksuara të BE-së e që duhet të dihet nga përkthyesit është emërtimi i politikave sipas takimeve. Një deklaratë shtypi tipike e BE-së mund të përmbajë një fjali të tillë si: *“Në Gymnich, muajin që vjen, Këshilli i Çështjeve të Përgjithshme do të diskutojë për zgjerimin e axhendës së Lisbonës, në zbatim të kriterëve të Kopenhagës për t’i shtrirë më tej detyrat e Petërsbergut”*. Kjo frazë ka këtë kuptim: *muajin që vjen, ministrat e punëve të jashtme të vendeve anëtare të BE-së do të mbledhen në një takim jozyrtar, i cili do të quhet takimi i Gymnich-ut sipas emrit të kështjellës gjermane ku është mbajtur takimi i parë i këtij lloji në vitin 1974. Ata do të diskutojnë për promovimin e reformave ekonomike liberale, të njohura si axhenda e Lisbonës pas një samiti të organizuar në Lisbonë, Portugali, ku është diskutuar kjo temë në vitin 2000. Ata do të shqyrtojnë po ashtu nëse shtetet aspirante për në BE i kanë përmbushur apo jo kriteret bazë (shtetin e së drejtës, respektimin e të drejtave të njeriut, krijimin e një ekonomie tregu funksionale e kështu me radhë), të njohura si kriteret e Kopenhagës pas një samiti në kryeqytetin danez ku kanë marrë jetë këto kritere në vitin 1993. Një tjetër çështje e rendit të ditës do të jetë zgjerimi i objektivave të ndërhyrjeve ushtarake që mund të ndërmarrë BE-ja; këto janë quajtur detyrat e Petërsbergut, sipas një takimi tjetër në një hotel me këtë emër në Gjermani (shembulli ilustrues marrë nga Manuali i Hartimit të Ligjeve).*

Emërtimi i politikave sipas emërtimeve të vendeve është proces sa i zakonshëm po aq dhe enigmatik i BE-së. Por sikur mos të mjaftonte kaq, BE-ja i referohet shpesh numrave duke e komplikuar dhe më shumë procesin e të kuptuarit për njerëzit në përgjithësi dhe për përkthyesit në veçanti. Për shembull, disa prej vendimeve më të rëndësishme të BE-së janë marrë nga komiteti 133 dhe komiteti 36 – të emërtuara mbështetur në nenin 133 të TKE-së dhe nenin 36 i TBE-së. Komiteti 133 organizon mbledhje me dyer të mbyllura çdo të premte dhe diskuton politikën tregtare, ndërsa komiteti 36 diskuton bashkëpunimin ndërmjet vendeve anëtare në fushat e drejtësisë dhe policisë. Me hyrjen në fuqi të Traktatit të Lisbonës, numrat e këtyre neneve kanë ndryshuar (si dhe emërtimi i vetë TKE-së), duke e vënë në pikëpyetje mbajtjen e numrave të vjetër nga komitetet, duke çuar kështu në më shumë vështirësi për deshifrimin e funksioneve të tyre.

Eurozhargoni përbën një ndër problemet përkthimore me të cilat duhet të merret përkthyesi.

### **Problemet kryesore që hasen në përkthimin e *acquis communautaire***

#### **a) Mostransferimi i koncepteve**

Gjatë përkthimit të *acquis communautaire*, disa koncepte janë të vështira për t'u shprehur në gjuhë të ndryshme për arsyen e thjeshtë që ato janë specifike për vende të caktuara, për shkak të tipareve të tyre gjeografike ose klimaterike. Për shembull, shtetet mesdhetare kanë fjalor të pasur termash të lidhura me kultivimin e ullirit. Ndërsa, Finlanda, Suedia, Danimarka nuk kanë mundësi klimaterike për të kultivuar ullinjët. Pavarësisht nga kjo, direktivat dhe dokumentet e tjera të BE-së për kultivimin e ullirit duhet të përkthehen dhe në finlandisht dhe në danisht. Procesi i

përkthimit të këtyre dokumenteve nuk është tekë rastësore, por detyrim që rrjedh nga Rregullorja nr. 1 dhe nga e drejta e fermerëve të këtyre shteteve për t'u njohur me skemat e subvencionimeve për homologët e tyre në vendet mesdhetare mbështetur në politikat bujqësore të BE-së. E njëjta logjikë është e vlefshme dhe për peshkimin në Baltik, dhe tolerimin e punës së fëmijëve në Mbretërinë e Bashkuar dhe në Danimarkë, pasi në Baltik nuk kultivohet peshku, ndërsa punësimi i fëmijëve nuk mund të tolerohet as në Mbretërinë e Bashkuar dhe as në Suedi.

Shohim shembullin më poshtë:

Peshku atlantik në Greqi

Një zgjidhje me vend, e cila është e saktë, por jo shumë e goditur për lexuesin, (në përjashtim të rasteve kur lexuesi është biolog), është përdorimi i emërtimeve latine të specieve në rastet kur nuk ka barasvlerës në gjuhën e synuar. Kjo praktikë ka qenë dhe vijon të jetë dhe sot e kësaj dite e nevojshme gjatë përkthimit në greqisht të *acquis communautaire* të Bashkimit Evropian, pasi Greqia nuk ka emra për specie peshku që nuk rriten në ujërat e Mesdheut. Arsyeja për marrjen e këtij shembulli është pasi Shqipëria dhe Greqia kanë kushte të njëjta klimaterike, shtrihen në të njëjtin rajon gjeografik dhe termat për këto specie peshku të Atlantikut nuk ekzistojnë si terma as në shqip. Pra, më specifikisht, në rastin e përkthimit të termit *Orphidion barbatum* (lloj peshku që rritet në Atlantik) në shqip rekomandohet të përdoret i njëjti term si në latinisht.

E njëjta logjikë zbatohet dhe kur përkthehen tekste rreth institucioneve dhe sistemeve arsimore, ligjore dhe të sigurimeve shoqërore të shteteve anëtare të BE-së. Për shembull, terma të tillë si “Chambre des députés”, “House of Commons”, ose “Bundestag” nuk mund të përkthehen në gjuhë të tjera për shkak të tipareve të organizimit juridik dhe

kulturore të këtyre institucioneve në vendet përkatëse. Për shembull, “Chambre des députés” nuk mund ta quash “Dhoma e Ulët”, pasi në këtë rast kuptimi nuk do të ishte i qartë për shumë lexues, dhe nëse thua “Dhoma e Ulët e sistemit parlamentar francez” do të ishte akoma më keq. Në varësi të lexuesit, ndonjëherë mund të jetë e pranueshme që “Chambre des députés” të përkthehet si “ekuivalenti francez i House of Commons”. Megjithatë, në raste të tilla, për shkak të tipareve dalluese kulturore dhe organizative të institucioneve dhe sistemeve të vendeve përkatëse, rekomandohet që termat të lihen në versionin e tyre në gjuhën burimore.

Po ashtu, në rastin e *common law*, koncepti e ka zanafillën në periudhën e mesjetës kur parimet gjyqësore të përbashkëta për shumë gjyqtarë në shumë rajone të Mbretërisë së Madhe u njohën në të gjithë vendin. Por shprehja e përdorur në vendet anglishtfolëse nuk nënkupton një sistem ligjesh që thjesht është trashëguar nga paraardhësit. Ideja dominuese është ajo e rregullave të përbashkëta siç tregohet qartë nga përkufizimi në Oxford English Dictionary: “The unwritten law of England, administered by the King’s courts, which purports to be derived from ancient and universal usage”. Megjithëse ndodh që termi ndonjëherë të haset në shqip i përkthyer si “*e drejta zakonore*” (përkundrejt të *drejtës kontinentale*), rekomandohet që termi të ruhet siç është në anglisht për shkak të traditës dhe historikut që mishëron.

Një tjetër shembull është përdorimi i termit *Rechtspfleger*, i cili vjen nga sistemi austriak i drejtësisë. Një ndër modelet e shqyrtuara në kuadër të reformës në drejtësi në Shqipëri, është prezantimi i mekanizmave dhe shpërndarja e punëve ndërmjet personave brenda sistemit gjyqësor në mënyrë që të ofrohet siguria juridike për shtetasit, domethënë që çështjet të trajtohen brenda afatit të arsyeshëm, pa vonesa dhe pengesa të tjera që do të çonin në mohimin e drejtësisë për shtetasit. Në Austri *Rechtspfleger*-at konceptualisht janë zëvendës gjyqtarë. Ata marrin vendime për çështje të thjeshta,



duke e lehtësuar punën e gjyqtarëve dhe duke u lënë atyre më shumë hapësirë për t'u marrë me çështje më të rëndësishme. Por, termi zëvendës gjyqtar në shqip nuk mund të përdoret pasi nuk ekziston si koncept në të drejtën e brendshme të vendit. Në këtë rast është mirë që termi të lihet ashtu siç është, ndërsa mund të shpjegohet me një shënim në fund të faqes se për çfarë bëhet fjalë konceptualisht.

E njëjta logjikë përdoret dhe për termat transpozim dhe harmonizim.

#### **b) Konceptet suprakombëtare dhe ruajtja e tyre në gjuhën e synuar**

Kur përkthehen tekste rreth koncepteve ligjore të rekomanduara ose të imponuara nga instrumente të ndryshme ligjore të BE-së, ndonjëherë përkthimi i termit gjenerik me termin “korrekt” specifik mund të krijojë probleme, edhe në rast se ekziston një barasvlerës ekuivalent. Përdorimi i një termi korrekt dhe specifik të shtetit në gjuhën e të cilit ofrohet përkthimi, mund të çojë në paqartësi. Shpesh sipas juristëve përkthyes preferohet termi suprakombëtar, jo ekuivalenti kombëtar.

Metoda e ruajtjes së koncepteve të BE-së është e pranueshme kur ajo përdoret për t'ju referuar termave tërësisht “evropianë”, të cilët nuk kanë ekuivalencë në nivelin kombëtar. Në këtë rast, këto terma mund të jenë të përshtatshëm pasi shmangin konfuzionin. Një shembull i kësaj kategorie është termi “subsidiaritet”, i cili nënkupton zbatimin e vendimeve dhe të masave në nivelin më të ulët të mundshëm rajonal, kombëtar ose të BE-së. Një shembull tjetër është termi “proporcionalitet”.

Për më shumë informacion rreth kësaj çështje, mund të shohim termin *acquis communautaire*, një ndër termat kyç të këtij punimi.

Termi *acquis* në frëngjisht përdoret gjerësisht në kuadrin e BE-së i papërkthyer. Ai përmbledh të gjithë trupën e legjislacionit të BE-së që prej krijimit të BE-së. Ai mbart po ashtu konotacionet e “*të gjitha gjërave të arritura, jo pa vështirësi*”. Pra i gjithë ky informacion jepet vetëm me një fjalë prej gjashtë germash. Kjo është arsyeja pse termi është lënë në versionin e tij në frëngjisht dhe për arsye të këtij punimi.

### c) Sloganet dhe lojërat e fjalëve

Në kuadrin e *acquis communautaire* përveç teksteve ligjore, duhet të përkthehen dhe shumë tekste “*quasi-ligjore*”, të tilla si raporte për transpozimin e instrumenteve të ndryshëm ligjorë.

Përgjithësisht sloganet dhe titujt bombastikë janë të papërkthyeshëm pasi mbështeten në kulturën specifike të shteteve të caktuara, dhe si të tilla, nuk janë të përkthyeshme në një kulturë tjetër. Po ashtu lojërat e fjalëve zakonisht mbartin shumë kuptim në pak fjalë dhe ka pak ose aspak të ngjarë që një gjuhë tjetër të ketë lojëra të barasvlershme fjalësh. Ndonjëherë kur përkthyesit mundohen “*të shpikin*” slogane dhe lojëra fjalësh në një gjuhë tjetër, duhet t’i kushtojnë kujdes të madh pranueshmërisë kulturore të tyre në gjuhën e synuar.

Le të shohim shprehjen “*a gift of change*” në anglisht. Kuptimi i saj është: duke dhuruar pak (qindarka), mund të sjellësh ndryshim në jetën e njerëzve. Sigurisht që shprehja mund të perifrazohet, por është shumë e vështirë (nëse jo fare e pamundur) që të gjendet një kombinim i tillë fjalësh në gjuhën shqipe.

Megjithatë, është me vend të theksohet, që edhe fjalët më të zakonshme kanë konotacione të ndryshme në shtete të ndryshme.

Le të shohim fjalën “green” në anglisht, “e gjelbër” në shqip. Kuptimi i parë i fjalës është ngjyra e gjelbër, mbase falë klorofilit. Por kuptimi simbolik ndryshon. Togfjalëshi “*Green Europe*” për francezët dhe spanjollët nënkupton bujqësinë, ndërsa për gjermanët nënkupton ruajtjen e mjedisit. Mbase anglezët mund ta lidhin me politikën ose kopshtarinë. Por problemi nuk përfundon këtu. Në gjuhë të tjera fjala “i gjelbër” ka konotacione nga më të ndryshmet, të tilla si *i ri*, *i papjekur* (portugalisht), madje dhe *i pisët* (në spanjisht).

Elementë të tillë gjuhësorë janë të shumtë në *acquis communautaire*.

### **Përkthimi si zgjidhje problemi**

Thuajse të gjitha përkthimet e *acquis communautaire* janë ndërdisiplinore në natyrë. Për pasojë, është logjike të thuhet që përveç aftësive në përkthim, përkthyesit ekspertë kanë nevojë dhe për një nivel të caktuar ekspertize rreth temës apo çështjes objekt i tekstit që ata përkthejnë (Fluck 1992:221; Lerat 1995:94). Por nëse vijojmë me të njëjtën logjikë, do të arrijmë në përfundimin se në qoftë se përkthyesit përpos vendimeve gjuhësore do të duhet të marrin dhe vendime ligjore, ata duhet të kenë aftësi si në përkthimi dhe në fushën e së drejtës (Šarčević 1994:303). Kompetenca ligjore presupozon jo vetëm njohuri të thelluara të terminologjisë ligjore, por edhe kuptim të plotë të arsytimit ligjor, aftësi për të zgjidhur probleme ligjore, për të analizuar tekste ligjore, dhe për të parashikuar dhe mënyrën sesi do të interpretohet dhe zbatohet një tekst nga gjykata.<sup>13</sup>

---

<sup>13</sup> Lidhur me interpretimin e teksteve, Gémar-i propozon që përkthyesit e ardhshëm ligjorë të mësohen të ndërtojnë tekste duke përdorur metoda ligjore të interpretimit. Në fakt ai shkon aq larg sa ta përcaktojë këtë aftësi si një ndër përparësitë kryesore të një programi trajnimi për përkthyesit e fushës ligjore (1995-II:154).

Nga sa më sipër, rrjedh natyrshëm që gjatë punës përkthyesit i duhet të përballet me sfidat që ngrihen nga probleme jo të hasura më parë, të cilat shfaqen në mënyrë të vazhdueshme dhe në forma nga më të paparashikuarat. Problemet që kërkojnë zgjidhje janë gjuhësore, social-kulturore, ligjore, stilistikore, etj. Në një fushë të specializuar, si ajo e përkthimit të *acquis communautaire*, asimetria e të dy sistemeve ligjore, e së drejtës së BE-së nga njëra anë, dhe e sistemit të brendshëm ligjor të Shqipërisë nga ana tjetër, është të paktën po aq e rëndësishme sa çështja e asimetrisë së gjuhëve të përfshira.

Ndërsa është e vështirë që të thuhet që në mjedisin shqiptar ka ekspertë përkthyes kompetentë si në përkthim dhe në fushën e së drejtës, më poshtë jepet një shtjellim i përgjithshëm i mënyrës sesi duhet të trajtohet teksti në gjuhën burimore në mënyrë që të përvetësohen sa më shumë aftësi në fushën e përkthimit dhe sa më shumë njohuri rreth fushës së të drejtës.

Duke filluar me gjuhën, në gjuhën angleze termat apo bashkëparaqitjet<sup>14</sup> janë më të thjeshta për t'u kuptuar për shkak të fjalorëve të shumtë online dhe fjalorëve fizikë të specializuar në këtë gjuhë. Shembuj të tyre janë fjalori Webster, thefreedictionary, Black's Law dictionary, Law – Marriam-Webster-online, Dictionary of Law, Oxford publication, e shumë burime të tjera. Po ashtu, një burim i mirë reference janë dhe glosarët e përgatitur nga Komisioni Evropian<sup>15</sup>, burimet linguistike dhe adresa të tjera reference të vlefshme për përkthyesit, si dhe udhëzimet për të shkruarin qartë dhe të qenët argumentues.

Mirëpo, në rastin e gjuhës shqipe, e njohur si një ndër gjuhët më të vjetra të Ballkanit, termat profesionalë dhe ato juridikë mendohet se mbështeten kryesisht tek huazimet, ashtu

---

<sup>14</sup> Në gjuhën angleze *collocations*.

<sup>15</sup> Për më shumë lexo [www.ec.europa.eu/translation](http://www.ec.europa.eu/translation)

si në shumicën e gjuhëve evropiane. Megjithatë, shpesh termat nuk gjenden në fjalorë. Materialet burimore dhe fjalorët e specializuar në gjuhën shqipe, për referencë për përkthyesit janë të kufizuara. Përkundër përpjekjeve modeste të bëra në hartimin e fjalorëve terminologjikë për fushën e jurisprudencës nga disa autorë, të cilët kryesisht janë bazuar në forcat e veta, ka pak përpjekje institucionale për hartimin e glosarëve të legjislacionit me bashkëpunim të profesionistëve të fushës, siç është rasti i glosarit të hartuar nën drejtimin e Organizatës për Sigurim e Bashkëpunim në Evropë (OSBE) (Hoxha et al. artikull). Disa prej fjalorëve që mund t'u vijnë në ndihmë studentëve apo përkthyesve janë: korpusi i specializuar i legjislacionit shqip dhe anglisht i hartuar nga Ali Caka ("Korpusi i specializuar i legjislacionit", Prishtinë 2009), fjalori i terminologjisë juridike anglisht-shqip, shqip-anglisht i Shefije Hasanit ("Law Dictionary English-Albanian, Albanian-English, Prishtinë 1998", fjalori i termave juridike, ekonomike dhe të biznesit, anglisht-shqip i Luan Kacelit, (Kaceli Luan, Fjalor termash juridike, ekonomike dhe biznesi anglisht-shqip, Dictionary of Law, Economy and Business English-Albanian, Tiranë 2002), si dhe Fjalori terminologjik për Drejtësinë, shqip-anglisht dhe anglisht-shqip i Kalo & Associates. Po ashtu, institucione të ndryshme ndërkombëtare kanë krijuar glosarë me termat më të hasura prej tyre, si për shembull Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (International Organization for Migration) (IOM), UNWomen (Zyra e Kombeve të Bashkuara për Gratë), dhe institucione të ndryshme kombëtare, të tilla si Ministria e Integritimit, Ministria e Bujqësisë, etj.. Fatkeqësisht glosarë të tillë nuk janë të disponueshëm online.<sup>16</sup>

Në kushte të tilla, përkthyesi duhet të jetë i përgatitur t'i përballojë problemet e reja e të shumta dhe nocionet e

---

<sup>16</sup> Ministria e Integritimit nuk ka ende të botuar online një glosar terminologjik.

pahasura më parë, shpesh të shtjelluara deri në imtësi ose të ndërthurura me shumë nocione të tjera, në mënyra novatore dhe të strukturuar. Atij i duhet të kryejë paralelisht detyrën e dekodimit të termave, të kuptimit dhe interpretimit të sintaksës, të nocioneve të tekstit në gjuhën burimore dhe kodimin e tyre në formën më të mirë të mundshme për përdoruesit në gjuhën e synuar. Gjatë kësaj pune përkthyesit, në rolin e *ndërmjetësit kulturor*, shpesh i duhet të mbështetet në hamendësime dhe në intuitë. Përkthyesi ecën përpara në punën e tij duke u mbështetur tek ajo çfarë ka mësuar/ditur më parë, duke iu drejtuar burimeve linguistike në dispozicion dhe duke trajtuar edhe konceptet e së drejtës në të paktën të dyja gjuhët.

E gjithë kjo do të thotë që paralelisht me punën me gjuhët, dhe plotësimin e repertorit gjuhësor, përkthyesit duhet të përditësojnë në mënyrë të vazhdueshme njohuritë që kanë për terminologjinë ligjore dhe procedurën në të dyja sistemet e së drejtës. Sikur të gjitha këto të mos mjaftonin, ndër të tjera, përkthyesit i nevojitet të bëjë përshtatje konceptuale, dhe të punojë me stilin dhe regjistrin e gjuhëve të përfshira.

Qëllimi i dy kreve të mëposhtëm të punimit është trajtimi i mënyrave më të shpeshta dhe më uniforme të problemeve të hasura në tekstet e *acquis communautaire*, me disa ilustrime praktike, duke u nisur nga prezumimi që përkthimi nuk është një punë tërësisht e çrregullt dhe as një punë kryekëput sistematike (Toury 1995:67). Qëllimi kryesor është që të identifikohen tipare të caktuara të rregullsisë, të kuptuara si mënyrat më të shpeshta dhe uniforme të trajtuarit të problemeve specifike të hasura në tekstet e *acquis communautaire*. Për shkak të paparashikueshmërisë dhe të shpeshtësisë së përdorimit, zgjidhjet e përkthimit të dhëna më poshtë mendohet të ofrojnë piketa dhe udhëzime të besueshme për përkthyesit e teksteve të kësaj natyre (Alcaraz, Hughes 2002:154).

### **Përkthimi i fjalorit të mirëfilltë teknik**

Për arsye të qarta, një ndër punët kryesore të përkthyesit të *acquis communautaire* është të përvetësojë një fjalor ligjor të krahasueshëm ndërmjet gjuhës amtare dhe gjuhës së synuar. Në vija të përgjithshme fjalori i *acquis communautaire* mund të ndahet në dy kategori: *fjalor simbolik* (për shembull, *court, states parties, applicant, case, misrepresentation, derogation, limitation, argument, prerogative*, (në shqip, *gjykatë, shtetet palë, kërkuesi, çështje, keqpërfaqësim, derogim, kufizim, argument, prerogativë*), dhe *fjalor funksional* (për shembull, *subject to, considering that, noting that, herewithin, under, whereby, hence, in accordance with, in virtue of, in the light of etc.*, (në shqip, *objekt i, duke marrë parasysh se, duke nënvizuar që, më poshtë, mbështetur/bazuar në, me anë të, nëpërmjet, për pasojë/për rrjedhim, në përputhje me, për shkak të/si rezultat i, nën dritën e etj.*).

#### **a. Problemet në përkthimin e termave teknikë të përbërë nga një fjalë**

Termet që i përkasin këtij grupi, pavarësisht se çfarë prejardhje kanë aktualisht, apo çfarë prejardhje mund të kenë pasur në të shkuarën, tani thuajse i përkasin tërësisht fjalorit ligjor, ose janë të lidhura ngushtë me këtë sferë në përdorimin e tyre të përditshëm. Disa prej tyre janë terma arkaike, dhe shpesh me origjinë anglo-normane. Në gjuhën moderne të së drejtës ka ende një grup të konsiderueshëm fjalësh në frëngjisht që kanë mbetur ‘pronë’ e juristëve. Këto fjalë dhe fraza të së drejtës franceze nuk kanë arritur të “natyralizohen” si në rastin e huazimeve. Ato përdoren më pak sesa janë

përdorur më parë, por luajnë gjithsesi rol të rëndësishëm si terma teknike, dhe si të tilla, përbëjnë pjesë aktive dhe të dallueshme të fjalorit ligjor. Shembuj të këtyre termave janë: *alien* (në kuptimin “e transferimit”), *amerce* (dënoj me gjobë), *cestui que trust* (personi që ka të drejtë për një interes përfitues), *de son tort* (shkelja e një detyre të besuar), *demurrer* (mungesë e bazës ligjore), *en ventre sa mere* (të drejtat e fëmijës së palindur/të fetusit), *esquire* (titull honorifik), *eyre* (ambulator/vajtje-ardhje), *fee simple* (pronësi absolute), *fee tail* (pronësi e kufizuar), *implead* (palë e tretë e shtuar), *lèse majesté* (krim kundër shtetit), *mainour* (në flagrancë), *malfesance* (abuzim), *metes and bounds* (pronë e patundshme), *save* (përveç/në përjashtim të), *specialty* (në kuptimin e “kontratës së vulosur”), *style* (dukje, sjellje), etj.

Këto fjalë dhe shprehje që e kanë kryesisht origjinën nga frëngjishtja do t'i linin pa gojë si francezët modernë po aq sa dhe anglezët modernë. Kështu, për shembull, *jeofail* në anglishten e vjetër do të thotë “kontroll”, njohja e një gabimi në procesin gjyqësor, nga *je faille*, “bëj gabim”. *Oyez* është forma urdhërore e foljes *oyer* “dëgjo”. Një *puisne judge* është një gjyqtar i ri (nga frëngjishtja e vjetër *puis né*). Ndërsa fjala ka mbijetuar, por ka pësuar ndryshim në mënyrën sesi shkruhet dhe në kuptimin që ka marrë, dhe shprehet në fjalën angleze *puny*. *Voir dire* mund të merret si *do të thotë* “to see him speak/ta shohësh të flasë” në frëngjishten moderne, por fjala në anglishten ligjore *voir dire* (që shkruhet ndryshe dhe *voire dire*) mbart kuptimin e frëngjishtes “to speak the truth/të thuash të vërtetën”, dhe ka të njëjtin kuptim si termi *voir dit* në frëngjishten e vjetër, i cili përfundoi si *verdict/vendim* në anglisht dhe në frëngjishten moderne.

Ndikimi i frëngjishtes shihet dhe në shumë terma ligjorë në të cilat mbiemri vjen pas emrit, gjë që përbën rend fjale të pazakontë në anglisht, por të zakonitë në frëngjisht. Shembuj të tillë përfshijnë: *attorney general/prokuror i përgjithshëm*, *body politic/grup i organizuar qytetarësh*, *court*



*marital/gjykatë ushtarake, freehold absolute/pronësi absolute, heir presumptive/trashëgimtar i prezumuar, issue male/trashëgimtarët meshkuj, letters patent/certifikatë patente, malice prepense/vrasje me paramendim (së bashku me përkthimin e saj të pjesshëm malice aforethought/paramendim keqdashës), proof demonstrative/prova materiale, proof positive/prova përfundimtare, e shumë të tjera si këto.*

Po ashtu, pjesa më e madhe e termave më të zakonshëm në anglishten ligjore i përkasin këtij grupi. Shembujt më tipikë janë: *legal/ligjor, illegal/i paligjshëm, judge/gjyqtar, bailiff/përmbarues, contract/kontratë, barrister/avokat*, dhe qindra terma të tjerë. Disa prej tyre mund të përdoren dhe të hasen dhe në prezantime të përgjithshme kur përdoren në kuptimin figurativ. Për shembull, nëse dikush është *a good judge of a painting*, ai është kritik i mirë i një pikturë; pra barasvlerësi i fjalës *judge* në këtë kuadër është kritik, gjykues, çfarë nënkupton që bëhet fjalë për dikë që ka aftësitë, kompetencat ose eksperiencën për të gjykuar një pikturë.

Megjithatë, fjalë apo shprehje të tilla nuk janë problem për ata që merren me përkthimin e *acquis communautaire*, pasi nëse i analizojmë kuptimet figurative të ilustruara më sipër, ato kanë tendencë të jenë monosemike dhe shpesh mbivendosen me konceptet ligjore të cilat i kanë bazat e forta në kulturat fqinje me të njëjtën histori. I vetmi problem në raste të fjalëve të tilla, është marrja e vendimit nëse termat nga gjuha burimore do të përkthehen, apo nëse ato do të lihen në anglisht (në versionin në gjuhën burimore), duke i përcaktuar si terma me karakteristika specifike, si produkt i kushteve lokale specifike të cilat nuk kanë barazvlerëse paralele në gjuhën e synuar.

Termtat *barrister* dhe *solicitor* shërbejnë si shembull i mirë për të ilustruar mungesën e barasvlershmërisë. Ndërkohë për një përkthyes të gjuhës shqipe, mund të duket se termat

nuk janë shumë të vështirë në momentin kur shfaqen secili veç e veç. Në këto raste është e qartë që bëhet fjalë për një avokat. Por çështja komplikohet në momentin që në të njëjtin tekst shfaqen krahas për krahas të dy termit, të cilët janë karakteristikë për sistemin e *common law*. Ndërkohë, nëse shohim fjalorin, përshkrimi që na jepet për *barrister* dhe *solicitor* është si më poshtë:

A **barrister** (also known as **barrister-at-law** or **bar-at-law**) is a member of one of the two classes of lawyers found in many common law jurisdictions with split legal professions. Barristers specialize in courtroom advocacy, drafting legal pleadings, and giving expert legal opinions. They can be contrasted with solicitors – the other class of lawyer in split professions – who have more direct access to clients, and may do transactional-type legal work. Barristers are rarely hired by clients directly, but instead are retained (or instructed) by solicitors to act on behalf of clients. In some legal systems, including those of Scotland, Belgium, South Africa, India, Pakistan, Scandinavian jurisdictions, Israel, Brazil, and the British Crown dependencies of Jersey, Guernsey and the Isle of Man, a professional with similar responsibilities is called an advocate.

(marrë nga Black's Law Dictionary)

Pra, është e qartë që në të dyja rastet bëhet fjalë për avokat, por për nivele të ndryshme profesionalizmi ndërmjet tyre. Më specifikisht, *solicitor* në anglisht është një lloj i veçantë avokati. Njëri prej tyre, pra ose *barrister*-i ose *solicitor*-i ka të drejtë të shkojë të mbrojë çështjen në gjykatë. Me fjalë të tjera, që të dy këta avokatë kanë të drejtë të përfaqësojnë klientët në gjykatë dhe të kryejnë punën e tyre të avokatisë. Njëri prej tyre merret me punën përgatitore, çfarë do të thotë me të gjithë punën që të çon në mbrojtjen e

çështjes në gjykatë. *Solicitor*-i merret me përgatitjen paraprake të çështjes ligjore. Plus, në rast se çështja i përket kategorive të çështjeve të zakonshme, pra ka të bëjë, për shembull, me shkëlqen e një kontrate, ose nuk është çështje penale, ajo mund të niset dhe të përfundohet nga avokati *solicitor* për shkak se pjesa më e madhe e këtyre çështjeve zgjidhen jashtë gjykate. Nga ana tjetër, avokati *barrister* konsiderohet shpesh si ekspert i fushave të caktuara të së drejtës. Në këto raste avokati *barrister* informohet, merr dosjen, dokumentet ku mbulohen të gjitha faktet e çështjes nga eksperti *solicitor*, dhe më pas bën përfaqësimin e klientit në gjykatë. Po ashtu, në gjykatat e shkallëve të larta e drejta e përfaqësimit të palëve në procese gjyqësore i takon vetëm *barrister*-it.

E gjithë analiza e mësipërme jepet për të argumentuar ndryshimet e sistemeve ligjore dhe mungesën e barazvlerësve në gjuhën shqipe. Në legjislacionin e brendshëm të Shqipërisë parashikohet prania e avokatëve civilë dhe e avokatëve penalë, ndërsa nuk ekziston e njëjta ndarje siç parashikohet në legjislacionin e vendeve me sistemin juridik të *common law*. Në rastin në fjalë, dy janë zgjedhjet e këtij problemi përkthimi: zgjidhja e parë është që termat të lihen në versionin e tyre në anglisht, duke dhënë një shpjegim në një shënim në fund të faqes për të bërë dallimin ndërmjet të tyre, ose zgjidhja e dytë, e cila sipas mendimit të autores së këtij teksti është më e përshtatshme, përkthimi i termit *solicitor* si ndihmës ligjor i avokatit (*barrister*) për çështje penale, ose për çështje në shqyrtim, në shkallë të larta gjykimi, dhe përdorimi i termit avokat për *solicitor* në rastet e çështjeve kontraktuale civile, administrative, etj. Duke ndjekur të njëjtën logjikë, termi *barrister* përkthehet thjesht si avokat. Po ashtu, rekomandohet që me anë të një shënimi në fund të faqes të jepet shpjegimi ndërmjet të dy termave.

Terma të tillë nuk shfaqen drejtpërdrejt në tekstet bazë të *acquis communautaire* pasi lidhen ngushtësisht me

kulturën dhe traditën e brendshme juridike të shteteve të caktuara. Gjithsesi është e nevojshme të dihet si të trajtohen probleme të tilla përkthimi, pasi ato janë shpesh pjesë e jurisprudencës së Gjykatës së Drejtësisë. Po ashtu, në kontestin shqiptar këto lloj problemesh përkthimi hasen shpesh në kuadrin e ndihmës teknike për reformimin e sistemit të drejtësisë.

Megjithatë përkthyesit e dokumenteve të *acquis communautaire*, veçanërisht ata që nuk janë të trajnuar për çështje të së drejtës, siç është rasti i pjesës më të madhe të përkthyesve në Shqipëri, duhet të konsultohen dhe të këshillohen me juristët e fushës. Këta të fundit shpesh nuk i presin mirë përshtatjet e termave, pasi i quajnë çështje teknike, dhe janë zakonisht në favor të ruajtjes së formave të njëjta dhe në versionin në shqip. Megjithëse ky argument qëndron, ka edhe raste kur nuk ka kuptim që termat në anglisht të përshtaten në shqip, pasi ato mund të kenë barazvlerësit apo ekuivalentë në gjuhën shqipe.

Megjithatë, disa terma ligjore që i përkasin këtij grupi, të tilla si *estoppel*, *deregulate/deregulation*, *derogate/derogation*, *delimit/delimitation* etj. në shumicën e rasteve mund të ruhen të pa përkthyer në gjuhën e synuar, ose për shkak se janë të dallueshëm dhe të njohur mirë ndërmjet profesionistëve të fushës, ose për shkak të kompleksitetit të tyre teknik dhe pamundësisë për të gjetur një term në gjuhën e synuar që e përfaqon të gjithë kuptimin e termit në gjuhën burimore. Në këto raste është më e rëndësishme që këto terma të kuptohen konceptualisht nga përkthyesi ose nga lexuesi i tekstit në gjuhën e synuar sesa të jepen të përkthyer.

Le të analizojmë arsyet pse do të ishte më mirë që termi *estoppel*, *deregulation*, *derogation*, *decriminalization* të lihen të pa përkthyer. Për këtë gjë, le të shohim për një moment kuptimin e tyre në kontekstin ligjor. Sipas [legal-dictionary.thefreedictionary.com](http://legal-dictionary.thefreedictionary.com), termat përkufizohen si më

poshtë:

*“Estoppel - a principle that prevents someone from making actions, statements or promises that are the opposite of what that person has earlier said, promised or otherwise implied (i.e. suggested without saying it directly) or done, or that go against a finding of a court of law, especially when this would result in loss or harm to another person”.*

Pra në shqip, kuptimi i termit është:

*Estoppel - kusht pengues për një palë që të ankohet ndërkohë që paraprakisht ka hequr dorë nga diçka e tillë; është një person që ka një të drejtë të ligjshme për të ngritur padi në rastet kur çështja është zgjidhur kundër interesit të tij, por që nuk mund të bëjë padi në një proces gjyqësor të mëpasshëm me të njëjtin shkak padie.*

Po ashtu, një tjetër argument që mund të shërbejë në favor të ruajtjes së këtij termi gjatë përkthimit në gjuhën shqipe është që termi *estoppel* shfaqet në versionin e tij në anglisht në tekstet e përkthyer në gjuhë të tjera, veçanërisht brenda fushës së të drejtës ndërkombëtare private.

*Deregulation: To free from regulation, especially to remove government regulations from: deregulate the airline industry.*

(sipas legal-dictionary.thefreedictionary.com)

*Deregulation: Changing laws that hinder free competition that let market forces drive the economy.*

(sipas Black's Law Dictionary)

Pra në shqip,

***Derregullimi*** është çlirimi nga rregullat, veçanërisht heqja e rregullave qeveritare për sektorë të veçantë, është ndryshimi i ligjeve që pengojnë konkurrencën e lirë dhe që e lënë ekonominë në duart e forcave të tregut.

Nëse do të vazhdohet më tej analiza, *derregullimi* në fakt është një lloj liberalizimi, por nuk është liberalizim i mirëfilltë pasi termi nuk nënkupton përfshirjen e të gjitha fushave të ekonomisë ose të funksionimit të jetës ekonomike/sociale të një shteti. Pra, termi liberalizim nuk mund të përdoret për të përkthyer termin ***deregulation***. Në një farë kuptimi, *derregullimi* është “*çrregullim*” pozitiv dhe zakonisht për sektorë me rëndësi të dorës së parë. Por as termi *çrregullim* nuk mund të përdoret në gjuhën shqipe, pasi ai nënkupton ndërhyrje negative. Si rrjedhojë logjike, sipas mendimit të autores do të ishte me vend që të përdorej termi ***derregullim*** në shqip.

Një tjetër term i kësaj kategorie përdorur rëndom nga media dhe forcat politike shqiptare është termi ***dekriminalizim***, i cili vjen nga fjala ***decriminalization*** në anglisht.

Shohim kuptimin e tij sipas fjalorëve në anglisht:

***Decriminalization***: *to remove or reduce the criminal classification or status of; especially: to repeal a strict ban while keeping under some form of regulation <decriminalize the possession of marijuana>*

(sipas legal-dictionary.thefreedictionary.com)

***Decriminalization*** or ***decriminalisation*** is the abolition of criminal penalties in relation to certain acts, perhaps retroactively, though perhaps regulated permits or fines might still apply (for contrast, see: legalization). The reverse process is criminalization.

(sipas en.wikipedia.org)

***Dekriminalizimi*** – heqja ose ulja e klasifikimit penal ose e statusit penal; veçanërisht shfuqizimi i një kufizimi rigoroz ndërsa ruhet një lloj rregullimi; heqja e dënimeve penale lidhur me akte të caktuara, mbase me efekt prapaveprues, megjithëse ende mund të përdoren leje ose gjoba; procesi i kundërt me përcaktimin e një akti si vepër penale.

Në kontekstin shqiptar, ky term nënkupton pastrimin (e parlamentit, të politikës dhe të administratës publike) nga persona që kanë kryer vepra penale në të shkuarën. Pra, në shqip duhet një fjali për të dhënë shpjegimin e termit për shkak të mungesës së ekuivalencës gjuhësore. Ndërsa autorja, bazuar në arsyet e sipërpërmendura e mbështetet përdorimin e termit ***dokriminalizim*** kur ai shfaqet, për shembull, në tekstin e Raportit të Progresit të BE-së për Shqipërinë, ajo është kundër përdorimit të tij në këtë formë nga mediat. Në çdo rast, ne si përkthyes duhet të dimë se për kë përkthejmë. Mediat i drejtohen qytetarëve të zakonshëm dhe duhet të flasin me gjuhë të kuptueshme për të realizuar funksionin kryesor të tyre, informimin e qytetarëve, kështu që sipas autores do të ishte e udhës që termi të shpjegohej ose të perifrazohej në rastin e përdorimit nga media.

Për shkrimin dhe përdorimin e termave të përmendura përdoren rregullat e drejtshkrimit të gjuhës shqipe.

#### **b. Termat teknikë të përbërë nga dy fjalë**

Më sipër, janë dhënë shembuj të fjalorit teknik që i përkasin termave me një fjalë ekuivalente. Megjithatë gjatë procesit të përkthimit të *acquis communautaire*, sidomos përkthimit të legjislacionit të BE-së lidhur me harmonizimin e legjislacionit të brendshëm të Shqipërisë me legjislacionin e

BE-së, përkthyesit do të hasen me shprehje të cilat kanë kuptim vetëm në kontekstin ligjor, megjithëse fjalët përbërëse të shprehjes i përkasin fjalorit të përgjithshëm të komunikimit të zakonshëm. Më poshtë jepen disa shembuj:

***burden of proof*** (*onus probandi*): “One consequence of the principle of the presumption of innocence is that the burden of proof in criminal cases is borne by the prosecutor.

Pra, në shqip, një ndër pasojat e parimit të prezumimit të pafajësisë është që ***barra e provës*** në çështjet penale i ngarkohet prokurorit.

***power of attorney***: (*a legal instrument authorizing one to act as another’s attorney or agent*); “The complainant shall grant his agent a power of attorney to enable negotiation of the contract”.

Pra, në shqip ankimuesi i jep avokatit ***prokurën*** për të negociuar kontratën.

***double jeopardy***: *double jeopardy is based on the principle that no person can be punished more than once for the same offense.*

Pra, në shqip kemi të bëjmë me termin ***kriminalitet i dyfishtë***.  
***in camera***: *When a legal trial is held before the judge in private chambers, where the public is not permitted to witness it, then it is called an in camera hearing. These are common in cases regarding family matters.*

Në shqip, kemi të bëjmë me konceptin e ***procesit gjyqësor me dyer të mbyllura***.



**qualified majority:** *the term refers to a specified majority of votes, such as 60 percent, required to approve a motion or pass legislation.*

Përkthimi në shqip është  **shumicë e cilësuar** dhe i referohet mënyrës së votimit me një shumicë të caktuar për të miratuar ligje të posaçme.

**effective remedy:** *refers to the legal instruments a state devices in order to ensure the protection of human rights of its nationals.*

Barasvlerësi i këtij termi në gjuhën shqipe është **mjet efektiv ligjor**, ose  **zgjidhje efektive** dhe i referohet instrumenteve të një shteti për të siguruar respektimin e të drejtave themelore të njeriut për nënshtetasit e tij.

**enters into effect:** *refers to the moment when a legal instrument becomes legally binding.*

Në shqip termi ekuivalent është  **hyn në fuqi**. Ai i referohet momentit kur një instrument ligjor bëhet i detyrueshëm për subjektet mbi të cilat ai zbatohet.

**habitual criminal:** *a person who has been convicted of two or more felonies, or of numerous misdemeanors, a fact that may increase punishment for any other future conviction/s.*

Në shqip bëhet fjalë për  **kriminel për vepra të përsëritura**.

**commencement of action:** *n. action (a lawsuit) commences (begins officially) when the party suing files a written complaint or petition with the clerk of the court. A plaintiff may prepare a summons and get a case number before filing a complaint.*

Në shqip bëhet fjalë për **çeljen e një çështjeje gjyqësore**.

**judicial review:** *It is a process wherein the courts have the power to examine the decisions of the lower courts or executive and legislative actions to determine whether it is against the constitution. It has the power to revoke the act if it is against the principles of the constitution.*

Në shqip barasvlerësi është **rishikim gjyqësor**. Në të drejtën e brendshme të Shqipërisë, rishikimi gjyqësor mund të lidhet me themelin e çështjes, ose me kushtetutshmërinë e saj. Në rastin e fundit rishikimi gjyqësor bëhet vetëm nga Gjykata Kushtetuese.

**judicial proceeding:** *The entire process in the court by which a legal judgment is reached upon by the judge or jury is called a judicial proceeding.*

Në shqip barasvlerësi është **proces gjyqësor**; shpesh ky term përkthehet në shqip si procedurë gjyqësore, gjë e cila është tërësisht e ndryshme nga procesi gjyqësor<sup>17</sup>.

Pjesë e kësaj kategorie janë dhe bashkëparaqitjet terminologjike, të njohura ndryshe në anglisht si *collocations*.

Shembuj të ngjashëm me sa më sipër janë të pafund në gjuhën angleze. Megjithatë, përveç fjalëve që i referohen një fjalori të specializuar, procesi i përkthimit nga gjuha burimore në gjuhën e synuar i nënshtrohet analizimit të çështjeve komplekse si rendit të fjalisë, organizimit sintaksor, tematizimit, modulimit, anaforës, dhe përzgjedhjeve stilistikore. Megjithatë, vendimet e marra për njësi të tilla janë veçse një copëz e punës shumë më kërkuese dhe të komplikuar të përkthyesit.

---

<sup>17</sup> Për më shumë lexo Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë.

### Përkthimi i fjalorit gjysmë teknik

Për përkthyesit, fjalori gjysmë teknik përbën një grup më kompleks, pasi në të përfshihen terma të cilët e kanë një kuptim, ose disa kuptime në jetën e përditshme, dhe një kuptim, ose disa kuptime në fushën e së drejtës. Përkthyesi nuk duhet t'i marrë si të mirëqena njohuritë paraprake për fjalë të tilla. Atij i duhet të bëjë zgjedhjen e duhur, të arsyetojë zgjedhjet e bëra dhe të japë opsionin më pranë versionit në tekstin burimor.

Le të analizojmë një grup termash të tillë:

#### *find*

(kuptimi i përgjithshëm):

1. To come upon, often by accident; meet with; (në shqip *përplasem me*<sup>18</sup>, *has*, shpesh aksidentalisht);
2. To come upon or discover by searching or making an effort: *found the leak in the pipe*; (në shqip *gjej*, si rezultat i kërkimeve ose përpjekjeve); p.sh. gjeti se ku rridhte tubi.
3. To discover or ascertain through observation, experience, or study: *found a solution*; ...; *found that it didn't really matter*. (në shqip *gjej*, *zbuloj*, *konstatoj*); p.sh. gjeti një zgjidhje; zbuloi se nuk kishte vërtetë rëndësi);
4. a. To perceive to be, after experience or consideration: *found the book entertaining*. (në shqip *rezultoi*) p.sh. rezultoi që libri të ishte shumë zbavitës.
- b. To experience or feel: *found comfort in her smile*. (në

---

<sup>18</sup> Përkthimet në shqip të kuptimeve të fjalës *find* janë bërë nga autorja e këtij punimi.

- shqip *vërej, shoh*) p.sh. pa paqe në buzëqeshjen e saj.
5. To recover (something lost): *found her keys*. (në shqip *gjej*); p.sh. gjeta çelësat e humbur;
6. To recover the use of; regain: *found my voice and replied*. (në shqip *mbledh veten*) p.sh. e mblodha veten dhe u përgjigja;
7. To succeed in reaching; arrive at: *The dart found its mark*. (në shqip *shënjoj, ia dal mbanë, arrij*); p.sh. shigjeta shënjoji në shenjë.
8. To obtain or acquire by effort: *found the money by economizing*. (në shqip *siguroj*); p.sh. i siguroi paratë duke kursyer;
9. To decide on and make a declaration about: *The jury deliberated and found a verdict of guilty. All the jurors found him guilty*. (në shqip *vendos*) p.sh. juria e shqyrtoi çështjen dhe vendosi shpalljen fajtor të të akuzuarit;
10. To furnish; supply. (në shqip *furnizoj*);
11. a. To bring (oneself) to an awareness of what one truly wishes to be and do in life. (në shqip *kuptoj*);
- b. To perceive (oneself) to be in a specific place or condition: *found herself at home that night; found himself drawn to the stranger*. (në shqip *ndihem si në ...*) p.sh. u ndjeva si në shtëpinë time; u ndje i tërhequr nga i huaji;

(shënim: kuptimet e fjalës *find* në anglisht marrë nga [www.thefreedictionary.com](http://www.thefreedictionary.com))

*find* - legal meaning (1): (n) deliver a formal judgement or judicial decision on the facts held proved and the applicable rules of law; - kuptimi ligjor, (*emër*) *vendimi i gjykimit mbështetur në faktet e provuara dhe në legjislacionin në fuqi*.

(v) comes to the conclusion that ... - si folje, *vendos, arrij në përfundimin se ...*

Siç del nga analiza e mësipërme, megjithëse kuptimet e përgjithshme të fjalës *find* janë të shumta, në anglishten ligjore ajo ka tërësisht kuptim ndryshe.

Për qëllime të këtij punimi, autorja është e mendimit se nuk ka vlerë që të ofrohet një listë më e gjatë e termave të kësaj kategorie, dhe madje as që të bëhet përpjekje për të klasifikuar fushat semantike ku mund të bëjnë pjesë këto fjalë. Ajo çfarë është e rëndësishme për t'u nënvizuar këtu, është që përkthyesit duhet të konsultohen me fjalorë të përgjithshëm dhe me fjalorë të specializuar sa më shpesh që të jetë e mundur, veçanërisht kur diçka në kontekst u lë atyre të kuptojnë se ka diçka jo bindëse në përdorimin e termave në kuptimin e tyre si në jetën e përditshme.

Le të shohim dy ilustrimet më poshtë, të cilat lidhen me fjalë shumë të zakonshme, dhe si përkthyes, ne jemi thujse tërësisht të bindur se këto fjalë për ne nuk paraqesin pikë vështirësie.

(teksti në gjuhën burimore)

The states parties shall

1. remind *athletes* and coaches:
  - a) to abstain from racist behaviour in all circumstances;
  - b) to report racist behaviour when it occurs;
2. remind referees:
  - a) to react appropriately where *athletes*, technical staff and/or supporters engage in racist gestures or expressions by imposing adequate measures and sanctions;
  - b) to mention in the referee report the occurrence of racist incidents during a sporting event;

Versioni i parë që të shkon ndërmend për përkthimin e fjalës ***athlete***, është atlet, por konteksti ku përdoret termi të lë të dyshosh pasi dokumenti flet për mosdiskriminimin racial në fushën e sportit. Atletizmi është pa dyshim një disiplinë e sportit, por në të ka dhe shumë disiplina të tjera. I ndodhur në këtë situatë jo shumë të qartë, përkthyesi i drejtohet fjalorit. Sipas Oxford Dictionary ***an athlete*** is a person who is proficient in sports and other forms of physical exercise. Pra, është e qartë që për projektin në fjalë, bëhet fjalë për sportistët, dhe jo për atletët. Përkthimi i saktë në shqip vijon më poshtë:

(teksti në gjuhën e synuar)

Shtetet palë duhet:

1. t'u kujtojnë ***sportistëve*** dhe trajnerëve:
  - a) të tërhiqen nga sjelljet raciale në të gjitha rrethanat;
  - b) të raportojnë sjelljet raciale, në rastet kur ato shfaqen;
2. t'u kujtojnë arbitrave:
  - c) të reagojnë siç duhet në rastet kur ***sportistët***, stafi teknik dhe/ose mbështetësit përfshihen në gjeste ose shprehje raciale duke marrë masat dhe sanksionet e nevojshme;

Në të njëjtin tekst, më poshtë, ndër të tjera shkruhet:

(teksti në gjuhën burimore)

As regards awareness raising measures, sports clubs and federations should publish announcements in sports competition programmes that they do not tolerate racism,

condemn racist chanting and the displaying of extreme right symbols and salutes, and will take appropriate action. Furthermore, they should make regular stadium announcements against racism and xenophobia on the scoreboard and by the stadium **speaker**, display anti-racism banners during sport events and, if possible, organise special anti-racism days. Finally, they should integrate the anti-racist message in their communication strategy (e.g. websites, game programmes, fan magazines, billboards).

Fjala **speaker** në anglisht jo vetëm që është ndër të parat fjalë që mësohet kur fillon të mësohet anglishten si gjuhë të huaj, por kuptimi ose kuptimet e saj, janë të gjitha të pranueshme në kontekstin e tekstit. Ajo çfarë të vjen në mendje në momentin e parë është *folës*, ose *komentator*, por në rastin e ilustruar më sipër nuk bëhet fjalë as për *folës*, dhe as për *komentator*, por për **altoparlant**. Një ndër kuptimet e fjalës **speaker** sipas Oxford Dictionary është “*an electroacoustic transducer; a device which converts an electrical audio signal into a corresponding sound*”. Shohim më poshtë përkthimin e paragrafit më sipër në shqip.

(teksti në gjuhën e synuar)

Lidhur me masat për rritjen e ndërgjegjësimit, klubet dhe federatat sportive duhet të bëjnë njoftime në programet e garave sportive se nuk e tolerojnë racizmin, i dënojnë thirrjet raciale dhe shfaqjen e simboleve dhe salutimeve ekstreme të djathta dhe se, në rast të shfaqjes së tyre, do të marrin masat e nevojshme. Për më tepër, ato duhet të bëjnë njoftime të rregullta në stadium, kundër racizmit dhe ksenofobisë në tabelën e rezultateve dhe nëpërmjet **altoparlantit** në stadium, të shfaqin banera kundër racizmit gjatë aktiviteteve sportive, dhe nëse është e mundur, të organizojnë ditë të dedikuara kundër racizmit. Së fundi, ato duhet të integrojnë mesazhe

antiraciale në strategjinë e tyre të komunikimit (p.sh. në faqen e internetit, programet e ndeshjeve, revistat e fansave, tabelat e reklamave).

Një tjetër term i cili ngatërrohet shpesh në tekstet e ndryshme, kryesisht në ato juridike është termi *prejudice*. Nuk ka pak raste kur përkthyesit i referohen kuptimit të përgjithshëm të këtij termi, pra e përkthejnë atë si *paragjykoj*, ndërkohë që teksti nuk ka fare lidhje me këtë koncept. Nëse do t'i referohemi një fjalori juridik, kuptimi i *without prejudice to* është *without detriment to any existing right or claim*, çfarë do të thotë që në shqip termi ka kuptimin e *pa cenuar, pa prekur*.

Në përfundim, ia vlen të theksohet se pavarësisht sesa mirë mendojmë se e dimë gjuhën e huaj, ose gjuhën amtare, është shumë e rëndësishme për përkthyesin që të konsultohet sa më shumë të jetë e mundur me fjalorët e gjuhës angleze dhe të gjuhës shqipe, madje dhe me fjalorë të gjuhëve të tjera, për t'u siguruar, që së pari ai të japë kuptimin e drejtë në gjuhën e synuar, dhe së dyti, të përdorë stilin, regjistrin dhe versionin më të mirë të mundur në varësi të tekstit objekt përkthimi.

### **Përkthimi i fjalorit të përgjithshëm**

Si koment i përgjithshëm mund të thuhet se termat e përfshira në këtë grup hasen më shpesh në një fushë të së drejtës, ose në një zhanër të caktuar ligjor. Karakteristikë e veçantë e këtyre termave është që kuptimi i tyre është më i thjeshtë të kuptohet, për shkak të kontekstit, sesa të riprodhohet në shqip. Për këtë arsye është e rëndësishme për studentët dhe për përkthyesit të kenë parasysh aspektet makro-strukture të lidhura me zhanrin e teksteve objekt përkthimi.

Për qëllime ilustrimi merren në analizë termat *qualify* dhe *challenge*, ndërsa lista e fjalëve që i përkasin kësaj kategorie është shumë e gjatë. Gjëja që duhet të mbahet



parasysh nga përkthyesi këtu, është që gjuha në tekstin burimor të jetë sa më e zhdërvjellët dhe sa më në harmoni me kontekstin. Për sa i përket kuptimit, këto terma nuk përbëjnë problem pasi kuptimi i tyre në fushën juridike nuk është larg kuptimit të tyre të zakonshëm.

Le të marrin së pari termin *qualify*, i cili është një term shumë i vështirë për t'u përkthyer, së bashku me fjalët e prejardhura prej tij, të tilla si "*qualification*", "*qualifying*" dhe "*qualified*". Ka të ngjarë që një pjesë e mirë e paqartësisë rreth këtyre termave ka të bëjë me përkthimin e shpejtë, të atypëratyshëm, dhe për pasojë me keqpërkthimin (Alcaraz, Hughes : 2002). Disa nga përdorimet më të shpeshta të termit janë:

*to qualify as a lawyer - për të qenë avokat*; është e rëndësishme të theksohet se përkthyesi duhet të marrë parasysh asimetrinë e sistemeve ligjore, gjë e cila mund ta çojë përkthyesin në modifikimin dhe përshtatjen e termit; është e qartë se nuk duhet të zgjidhet një term që demonstroi vetëm që dikush ka një diplomë juridiku, por një term që përfshin dhe gjithë trajnimin dhe kualifikimet e nevojshme për të qenë avokat ose për të shërbyer si avokat.

*highly qualified lawyers - juristë të njohur të fushës*; edhe në këtë rast mund të duhet të përdoret modulimi pasi "*qualification*" që në anglisht i referohet diplomave, akreditimit profesional dhe përvojës. Në këtë rast përkthyesit i duhet të gjejë një shprehje që shpreh si prestigjin dhe aftësinë deklarative, ashtu edhe njohjen bazë të profesionit.

*qualified privilege – imunitet i kushtëzuar/imunitet i pjesshëm*; në togfjalëshin më sipër, *qualified* shfaqet në kuptimin "*limited*", ose "*in special circumstances*";

***qualified majority – shumicë e cilësuar***; termi i referohet një shumice të domosdoshme për të miratuar një ligj, ose për të marrë një vendim.

***qualifying date – datë kualifikuese***; në këtë rast, përkthimi i dhënë është më pranë kuptimit të shprehjes në anglisht. Termi në gjuhën burimore nënkupton që dikush “*ka të drejtë/qualifies*” të jetë objekt i gëzimit të një të drejte vetëm nëse aplikon për të deri në një datë të caktuar.

***qualifying period – periudhë kualifikuese***; dhe në këtë rast kemi të bëjmë me kuptimin e “*pasjes ose gëzimit të një të drejte*” deri në një periudhë të caktuar, të specifikuar në ligj.

Siç mund të shihet nga shembulli i mësipërm, megjithëse bëhet fjalë për togfjalësja në pamje të parë të thjeshtë në anglisht, analizimi dhe kuptimi i tyre në kontekstin ku shfaqet, dhe më pas, dhënia e një ekuivalenti gjuhësor dhe teknik të duhur në gjuhën e synuar kërkon punë dhe kërkime në të dyja gjuhët dhe sistemet ligjore.

Është e rëndësishme të theksohet se të njëjtat probleme të përkthimit shfaqen dhe me shumë terma të tjerë, të tillë si “*report*”, “*issue*”, “*create*”, “*application*”, “*disclose*”, “*inform*”, “*hold*”, “*maintain*”, dhe shumë e shumë terma të tjerë. Siç u theksua edhe më sipër, këto janë fjalë që në pamje të parë nuk përbëjnë problem për përkthyesin. Megjithatë, ilustrimet lidhur me termin “*qualify*” dhe “*challenge*” janë të mjaftueshme për të rritur ndërgjegjshmërinë e përkthyesit për të qenë të vëmendshëm lidhur me këtë kategori termash.

### **Përkthimi i fjalorit funksional**

Me fjalor funksional në kuptimin e këtij punimi

nënkuptohen termat e përdorura për të ndërlidhur në një tekst elementët kryesorë linguistikë, ose blloqet e fjalëve të kuptimita. Çdo fushë e specializuar ka fjalorin e vet funksional. Për shembull, lidhësit logjikë të natyrës formale, të tilla si “*hence*”, “*thus*”, “*hereinafter*”, etj. gjenden gjerësisht në instrumentet ligjore të Bashkimit Evropian. Shembuj të fjalorit funksional jepen më poshtë:

***hereinafter*** – ***më poshtë***; për shembull:

“This paragraph reproduces Article 204 of the Treaty establishing the European Community (***hereinafter*** referred to as the EC Treaty).

Përkthimi në shqip:

“Ky paragraf riprodhon nenin 204 të Traktatit themelues të Komunitetit Evropian (***më poshtë*** Traktati i EC-së);

***aforesaid/aforementioned*** – ***i sipërpërmendur***; për shembull:

“In the dealings with the ***aforementioned*** state ...”, i cili në shqip përkthehet: “në marrëdhëniet me shtetin e ***sipërpërmendur*** ...”;

***under*** – ***mbështetur në***; për shembull:

“ ***under*** section III of this Article, appropriation shall mean ...”, i cili në shqip përkthehet “***mbështetur në*** pjesën III...”;

***subject to*** – ***objekt i***; për shembull:

The parties ***subject to*** this Convention ..., e cila në shqip përkthehet “palët ***objekt i*** kësaj Konvente”; ose

***concerning*** – ***lidhur me***; për shembull:

Council Directive 93/42/EEC, of 14 June 1993, *concerning* medical devices ..., e cila në shqip përkthet si “Direktiva e Këshillit ... *lidhur me* aparaturat mjekësore ...”

*pursuant to* – *sipas, mbështetur në*; për shembull:

*pursuant to* Article 13 of Law no ..., e cila në shqip përkthehet në “ *sipas* nenit 13 të Ligjit nr. ...”

*in accordance with, according to, in line with* – *në përputhje me*; për shembull:

*in accordance with* Council Directive concerning occupational health and safety ..., e cila në shqip përkthehet “*në përputhje me* Direktivën e Këshillit për shëndetin dhe sigurinë në punë ...”

Megjithëse për përkthyesin këto fjalë nuk paraqesin vështirësi kuptimore, është e rëndësishme që për to të gjenden barasvlerësit përkatës në zhargonin juridik. Një listë e plotë përkthimesh për këto fjalë mund të gjendet në Manualin e hartuar nga Ministria e Integritimit, përmendur më sipër në këtë dokument.

### **Dokumentacioni mbështetës në përkthim**

Meqë e drejta është shkencë shoqërore, dukuritë që ajo përshkruan janë vështirësisht të kalueshme nga një gjuhë në një tjetër, ose nga një sistem në tjetrin. Për më tepër, prania e sistemeve të ndryshme juridike shkakton problemin e mospërputhjes së nocioneve ose të termave. Në një kornizë ku përkthimi duhet të kapërcejë pengesat gjuhësore dhe ligjore të

shkaktuara nga prania e sistemeve të ndryshme juridike, përkthyesi përdor mjete ose mënyra që i bëjnë të mundur të kryejë punën e tij. Çështja qëndron se ku duhet t'i gjejë këto burime përkthyesi dhe nga duhet të fillojë kërkimin dokumentar.

Gémar-i sugjeron kërkimin e dokumentacionit që kalon në tri faza. Faza e parë është leximi dhe analiza e tekstit, faza e dytë është evidentimi dhe paraqitja e termave dhe e nocioneve të panjohura, dhe faza e tretë është kërkimi i barasvlerësve. Problemi, thotë Gémar-i, është i kriterit metodologjik, sepse "*bëhet fjalë për një zgjedhje në një fushë që karakterizohet nga një mori termash, nga polisemia kronike dhe sinonimia jo më pak e rëndësishme*". Përveç kësaj, terminologjia është e vështirë të "eksportohet" meqë realiteti juridik i një vendi nuk mund të kalohet krejt pa pësuar ndonjë dëm për shkak të dallimeve socio-kulturore dhe socio-ekonomike që pasqyrohen në institucione (Gémar : 1979).

Një tjetër problem që krijojnë fjalorët, sipas Gémar-i, vjen nga njëra anë, sepse ata sugjerojnë zgjidhje të tipit "receta kuzhine" dhe nga ana tjetër, shembujt që na ofrojnë janë shpesh përkthime dhe jo tekste origjinale. Për më tepër, fjalorët, edhe për arsye metodologjike, nuk mund të sigurojnë të gjitha kontekstet në të cilat mund të përdoret një term. De Groot-i, si Gémar-i, shpreh keqardhjen për faktin se fjalorët nuk e ofrojnë kontekstin ku mund të shfaqen termat që ata sugjerojnë, si në gjuhën origjinale edhe në gjuhën e synuar. De Groot-i beson se fjalorët duhet të përmbajnë vetëm sugjerime për përkthimin e termave nga një sistem juridik në një sistem tjetër juridik dhe se çdo përkthim u përket dy sistemeve në të njëjtën kohë.

Për shkak të besueshmërisë së ulët të fjalorëve, sidomos të fjalorëve shumëgjuhësh, Gémar-i rekomandon, së pari, përdorimin e fjalorëve apo enciklopedive juridike njëgjuhëshe, si në gjuhën burimore edhe në gjuhën e synuar. Një fjalor i mirë duhet t'u përgjigjet kriterëve të

besueshmërisë, dobisë dhe të jetë sa më shterues. Besueshmëria përcaktohet nga cilësia gjuhësore e fjalëve, nga përkufizimet, nga barasvlerësit e propozuar dhe nga shkalla e vjetërimit të terminologjisë. Nuk duhet harruar se e drejta është shkencë shoqërore, dhe për këtë arsye, ajo ndjek zhvillimin e shoqërisë. Besueshmëria varet edhe nga mënyra e paraqitjes, nga qartësia e formulimit, nga thellësia dhe nga saktësia e përkufizimeve. Dobia e një fjalori varet shumë nga kriteret e plotësisë dhe të besueshmërisë.

Së fundi, me kriteret shteruese Gëmar-i nënkupton seriozitetin e autorëve për kërkimin dhe përdorimin e terminologjisë në fushën përkatëse. Fjalori sistematik i terminologjisë i Rachel Boutin-Quesnel-it, etj. tregon se një fjalor terminologjik që përqendrohet vetëm tek një fushë e së drejtës, përfshin në përgjithësi një shkallë të lartë të të qenët shterues.

Le të shohim shembujt e mëposhtëm:

(teksti në gjuhën burimore)

*In their **applications** to the European Court, the applicants contended that their sentences were **grossly disproportionate**, being four to five times longer than the sentences they would have been likely to receive had they been convicted of the same offences in the United Kingdom and that their continued enforcement violated their rights under Article 3 of the Convention. They further complained under Article 5 that their continued **detention was arbitrary** as, owing to the way the prisoner transfer agreement worked, had they in fact pleaded not guilty, they would have ended up serving less time in prison. The first applicant also argued that an “**irrebuttable presumption**” had been applied in his case which had rendered his **trial flagrantly unfair**, such that his continued detention in the United Kingdom was arbitrary.*

*Law – Article 3: While in principle matters of **appropriate sentencing** largely fell outside the scope of the Convention, the Court accepted that a grossly disproportionate sentence could amount to **ill-treatment** contrary to Article 3 at the moment of its imposition. However, **gross disproportionality** was a **strict test** and would only be met in very exceptional circumstances. Further, due regard must be had for the fact that sentencing practices vary greatly between States owing to different domestic conditions and approaches. When considering the degree of humiliation or suffering inherent in the impugned acts, it was necessary to have regard to the degree of humiliation or suffering inherent in the alternative option.*

*(teksti në gjuhën e synuar)*

Në **aplikimet** në Gjykatën Evropiane, **aplikuesit** pretendojnë se dënimet kundër tyre ishin **shumë në përpjesëtim të zhdrejtë** me veprat e kryera, duke qenë katër deri në pesë herë më të gjata se dënimet që ata do të kishin marrë nëse do të gjykohehin për të njëjtën vepër penale në Mbretërinë e Bashkuar, dhe se vazhdimi i vuajtjes së dënimit shkelte të drejtën e tyre, bazuar në Nenin 3 të Konventës. Ata u ankuan më tej për shkelje të Nenit 5 duke pretenduar se **vazhdimi i vuajtjes së dënimit për ta ishte arbitrar**, pasi duke pasur parasysh mënyrën sesi funksionon marrëveshja për transferimin e të burgosurve, në rast se ata nuk do të kishin pranuar fajësinë, do të kishin përfunduar në kohë më të shkurtër vuajtje dënimi. Aplikuesi i parë pretendonte po ashtu se “**prezumimi i patjetërsueshëm**”, i zbatuar në çështjen kundër tij, në fakt e kishte bërë procesin ligjor **të padrejtë në mënyrë flagrante**, aq sa vazhdimi i vuajtjes së dënimit për të në Mbretërinë e Bashkuar ishte arbitrar.

*Ligji – Neni 3: Ndërkohë që në parim çështjet e **dënimit të përshatshëm** bien kryesisht jashtë objektit të Konventës, Gjykata pranon që një dënim shumë në përpjesëtim të zhdrejtë*

*me veprën e kryer çon në keqtrajtim, në kundërshtim me Nenin 3, në momentin e zbatimit. Gjithsesi, papërpjesëtueshmëria e madhe është test strikt dhe testi realizohet vetëm në raste shumë përjashtimore. Për më tepër, i duhet kushtuar rëndësia e nevojshme faktit që praktikat e dënimit ndryshojnë shumë nga një shtet në tjetrin, për shkak të kushteve dhe të qasjeve të brendshme të tyre. Kur shqyrtohet niveli i përçmimit ose i vuajtjes si pjesë e akteve të vendosura, është e rëndësishme të merret parasysh niveli i përçmimit ose i vuajtjes në opsionin alternativ.*

Këto fragmente të marra nga një vendim gjykatë, dëshmojnë qartë se termat e përfshira në të, zor se mund të gjenden në fjalorë terminologjikë. Për t'i kuptuar e më pas për të gjetur barasvlerësi përkatëse në gjuhën e synuar është e rëndësishme të konsultohen ekspertët e fushës dhe jurisprudenca e Gjykatës. Termat në lëmin e vendimeve të gjykatës janë dhe më shumë specifike sesa vetë termat e së drejtës së komunitetit. Në rastin më sipër, për *application* është përdorur *aplikim*, dhe për *applicant* është përdorur termi *aplikant*. Në zhargonin e gjykatës ekspertët kanë rënë dakord që termat të përkthehen si më sipër, megjithëse e drejta shqiptare dhe fjalorët ligjorë terminologjikë flasin *për padi*, *kërkesë*, *ankesë akt-padi* dhe *për ankimes në procesin penal*.

Konventa Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut flet po ashtu për masa në përpjesëtim të drejtë dhe të zhdrejtë, kështu që togfjalëshi *në përpjesëtim të zhdrejtë* vjen natyrshëm si zgjidhje për *grossly proportionate*. Po ashtu, termat *ill-treatment* and *strict test*, zor se gjenden të versionin e tyre të saktë në fjalorë terminologjikë, ndërkohë që janë terma të thjeshtë për ekspertët dhe hartuesit ligjorë.

Konsultimi i dokumentacionit juridik dhe njohja me punën e bërë më parë nga përkthyesit, është e domosdoshme për të qenë në gjendje të ruhet konsistenca gjuhësore, juridike dhe për të siguruar besueshmërinë e tekstit të përkthyer.



### **Shembuj praktikë të përkthimit të terminologjisë**

Çështja e përkthimit të saktë të termave në varësi të fushës ose zhanrit të tekstit është një makth i vërtetë jo vetëm për përkthyesit e rinj, por edhe për përkthyesit me përvojë. Në rastin e *acquis communautaire* puna bëhet edhe më e vështirë për shkak të faktit, që ashtu siç është trajtuar dhe më sipër në këtë punim, fushat e së drejtës së komunitetit mbulojnë çdo sferë të shoqërisë, duke filluar me fusha të përgjithshme dhe më të prekshme për të gjithë, të tilla si sigurimi dhe gëzimi i të drejtave themelore të njeriut, dhe duke vijuar me fusha shumë specifike, të tilla si patentat, e drejta intelektuale, krimi kibernetik, mbrojtja e të dhënave personale, etj.

Në përpjekje për të dhënë një ide më të qartë se çfarë nënkuptohet me terminologji në këndvështrimin e përkthyesve, autorja i është referuar specifikimit të mëposhtëm të përdorur nga Ministria e Integritimit e Shqipërisë për bashkëpunëtorët përkthyes për atë pjesë të *acquis communautaire* të përkthyer deri më tani në shqip.

*“Gjatë përkthimit të akteve ligjore, do të bëhet përzgjedhja e termave të cilët përkojnë me përkufizimin e mëposhtëm:*

*“Në gjuhët specifike, termi është një njësi gjuhësore përbërë nga një fjalë e vetme ose një kombinim fjalësh, që zakonisht lidhet me përkufizimin tradicional kur përdoret nga folës të një fushe specifike të dhënë. Një njësi terminologjike mund të jetë gjithashtu një simbol, një formulë kimike ose matematike, një emër shkencor në latinisht, një akronim, ose titulli zyrtar i një organizate, një organ administrativ ose titulli i punës i një individi”.*

Po ashtu, më poshtë në të njëjtin dokument thuhet:  
*“Parametrat që duhet të respektohen me qëllim ruajtjen e uniformitetit të përmbajtjes së përkthimit janë si më poshtë:*

- a) *Përputhja e terminologjisë*: Përkthimi duhet të respektojë terminologjinë e fushës përkatëse të aktit ligjor, duke iu referuar terminologjisë së vënë në dispozicion nga Ministria e Integritit. Për të siguruar përputhje terminologjike, çdo koncept shprehet nëpërmjet një termi ose togfjalëshi të veçantë. ...”

Pra, detyra për respektimin e terminologjisë është e sanksionuar, dhe nuk i lihet në dorë dëshirës së përkthyesit. Gjuha dhe terminologjia ligjore janë të komplikuar dhe çojnë në vështirësi për shkak se: a) konceptet ligjore janë abstrakte; b) termat e marrin kuptimin nga konteksti; c) çdo sistem ligjor krijon kontekstin e tij, dhe d) qëllimi i sistemit ligjor është të ofrojë një përgjigje ligjore në një grup të caktuar rrethanash për t’ju përgjigjur pyetjes “çfarë është e drejta”.

Po ashtu është e rëndësishme të nënvizohet se *sistemet ligjore* krijohen dhe marrin trajtë më të qartë nga eksperiencia. Me kalimin e kohës krijohen gjithnjë e më shumë koncepte, dhe për rrjedhojë, shtohen termat e lidhura me fusha më të ngushta ekspertize.

Megjithatë, në mënyrë që të kuptohet qartë filozofia e dasive të së drejtës së BE-së dhe e së drejtës së brendshme shqiptare, është e rëndësishme të shihen eksperiencat historike, kushtet gjeografike, ekonomike, zhvillimet individuale, dhe prezantimi i termave specifike. Është po ashtu e rëndësishme të identifikohen ngjashmëritë e mundshme, pra strukturat bazë të përbashkëta me sistemet e tjera ligjore, origjinat e njëjta, konceptet e përbashkëta, apo të përshtatura në sistemet ligjore.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm dhe lehtësues për punën gjatë përkthimit është identifikimi i familjeve ligjore të korpuseve të të dyja sistemeve, pra nëse *acquis communautaire* ka më shumë karakteristika të ngjashme me *common law*, apo me të drejtën romake. Përkthyesit duhet të

marrin parasysh dhe faktin që termat marrin formë dhe përshtaten brenda sistemit ku ato gjenden për të krijuar një marrëdhënie së bashku me konceptet e tjera dhe për të formuar pjesë të një rrjeti kompleks konceptesh. Me fjalë të tjera, megjithëse termat mund të jenë të qartë në tekstin në gjuhën burimore, është e rëndësishme që përkthyesi të bëjë kërkimet e tij në gjuhën e synuar dhe të sigurohet për një marrëdhënie organike ndërmjet termave në kuadrin më të gjerë të koncepteve objekt trajtimi.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm për t'u kuptuar nga përkthyesi, është që kuptimi gjuhësor dhe kuptimi ligjor nuk janë e njëjta gjë. Për ta konstatuar këtë gjë mjafton të lexohen çështjet ku gjyqtarët analizojnë tekstet e instrumenteve ligjore të detyrueshme për palët. Kuptimi ligjor rrjedh nga shumë faktorë si, për shembull tekstet, faktet, synimet, qëllimet, sistemi si i tërë, çfarë lejohet dhe nuk lejohet sipas sistemeve përkatëse, mënyrat e të vepruarit, procedurat që duhen ndjekur, etj. Po ashtu, ka mënyra të ndryshme ligjore të të lexuarit të një teksti. Një tekst mund të lexohet në mënyrë të gjerë, ose në mënyrë të ngushtë. Kuptimi gjuhësor analizon formulimin apo fjalën brenda tekstit, por edhe e lidh formulimin apo fjalën me tekste të tjera, pra merr parasysh ndërtekstualitetin, ndërsa tekstet ligjore u referohen teksteve të tjera si referenca.

Shohim tekstin e mëposhtëm.

(teksti në gjuhën burimore marrë nga  
[www.echr.coe.int](http://www.echr.coe.int))

#### Article 13

#### Right to an *effective remedy*

Everyone whose rights and freedoms as set forth in this Convention are violated shall have an *effective remedy* before

a national authority notwithstanding that the violation has been committed by persons acting in an official capacity.

Neni 13

E drejta për *zgjidhje efektive*

Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtë një *zgjidhjeje efektive* para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare.

(përkthim zyrtar marrë nga [www.qbz.gov.al](http://www.qbz.gov.al))

Neni më sipër në të dyja versionet si në anglisht dhe në versionin zyrtar të përkthyer në shqip janë marrë për t'i shërbyer analizës së tekstit më poshtë.

(teksti në gjuhën burimore)

The Convention requires that a “*remedy*” be such as to allow the competent domestic authorities both to deal with the substance of the relevant Convention complaint and to *grant appropriate relief*. A remedy is only *effective* if it is available and sufficient. It must be sufficiently certain not only in theory but also in practice, and must be effective *in practice as well as in law*, having regard to the individual circumstances of the case. Its effectiveness does not, however, depend on the certainty of a favourable outcome for the *applicant*.

(teksti në gjuhën e synuar)

Që një “*zgjidhje të jetë efektive*” Konventa kërkon që ajo t’i lejojë organet e brendshme kompetente të merren si me thelbin e ankesës përkatëse lidhur me shkeljen e një të drejte të Konventës, dhe me dhënien e *dëmshtëpërblimit të përshatshëm*. Një *zgjidhje është efektive* vetëm nëse ajo ekziston dhe është e mjaftueshme. Ajo duhet të jetë mjaftueshmërisht e sigurt jo vetëm në teori, por edhe në praktikë, dhe duhet të jetë efektive *si në praktikë dhe në ligj*, duke marrë parasysh rrethanat individuale të çështjes. Megjithatë, efektiviteti i saj nuk varet nga siguria e rezultatit të favorshëm për *ankimuesin*.

Për të qenë në gjendje të përkthejë një tekst të tillë, përkthyesi duhet të njohë mirë Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Kur flitet “për njohje të mirë” bëhet fjalë për njohje të Konventës dhe të interpretimeve të saj kryesore nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe për kuptim të plotë të koncepteve për të cilat bën fjalë teksti. Për shembull, Konventa në nenin 13 të saj flet për *zgjidhje efektive*. Në kuptimin e këtij neni zgjidhjet efektive janë mjetet e vëna në dispozicion nga shtetet palë në Konventë për t’u lejuar nënshtetasve të tyre të gëzojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të garantuara nga Konventa.

Po ashtu, duhet të nënvizohet se për tekste të natyrave të tilla, është e rëndësishme që të lexohen dhe raporte të nxjerra më parë nga shtetet përkatëse për të ditur se cilat janë zhvillimet dhe qëndrimet në to, lidhur me paditë e ngritura ndaj tyre.

Një tjetër element në të cilin autorja do të donte të tërhiqte vëmendjen e lexuesit është termi *applicant*. Në pjesën dërrmuese të vendimeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut për çështjet e ngritura kundër Shqipërisë, ky term është përkthyer si *aplikant*, fjalë e cila nuk është fjalë shqipe. Ndërkohë, këtu nuk jemi në kushtet e mungesës së termit në gjuhën shqipe, pasi procedura civile flet për *ankim*, *ankesë*,

*ankimim*, kështu që termi korrespondent më i saktë do të ishte *ankimues*, ose *kërkues* në vend të termit aplikant.

Shohim më poshtë për më shumë:

(teksti në gjuhën burimore)

Article 13 does not require any particular form of remedy, States having a *margin of discretion* in how to comply with their obligation, but the nature of the right at stake has implications for the type of *remedy* the State is required to provide. Even if a single remedy does not by itself entirely satisfy the requirements of Article 13, the aggregate of remedies provided for under domestic law may do so. In assessing effectiveness, account must be taken not only of formal remedies available, but also of the general legal and political context in which they operate as well as the personal circumstances of the applicant.

(teksti në gjuhën e synuar)

Neni 13 nuk kërkon një formë të caktuar zgjidhjeje, duke u dhënë kështu *një prag vlerësimi* shteteve për të zgjedhur mënyrën sesi ta realizojnë këtë detyrim, por natyra e të drejtës në fjalë, ka implikime për llojin e *mjetit efektiv* që i kërkohet shtetit të ofrojë. Edhe në rast se një zgjidhje e vetme në vetvete nuk i plotëson tërësisht kërkesat e nenit 13, shumatorja e zgjidhjeve të parashikuara bazuar në legjislacionin e shtetit në fjalë, mund ta bëjë këtë gjë. Gjatë vlerësimit të efektivitetit, nuk duhet të merren parasysh vetëm zgjidhjet formale të disponueshme, por edhe kuadri i përgjithshëm ligjor dhe politik brenda të cilit ato funksionojnë, si dhe rrethanat personale të ankimesit.

Termi *margin of appreciation* nuk gjendet në tekstin e Konventës, por nëse përkthyesi i drejtohet vendimeve bazë

të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut do të shohë që nocioni i *pragut të vlerësimit* është trajtuar shumë herë dhe në detaje nga ky institucion. Ndërkohë që më sipër flitet për nenin 13 të Konventës që flet për *effective remedy* (pra, për *zgjidhje efektive*), më sipër togfjalëshi është përkthyer si *mjet efektiv*. Megjithëse në pamje të parë të duket një rrëshqitje përkthimi, në fakt nëse Konventa lexohet në nenet vijues të saj, do të vihet re se ajo flet dhe për *mjete efektive* (në versionin në shqip) në përgjigje të termit *remedy*. Është e rëndësishme të theksohet se ky nen përbën shkelje të Konventës kur kombinohet me një tjetër nen të Konventës. Pra, me fjalë të tjera, *mjeti efektiv* është vetëm një pjesë e *zgjidhjes efektive*.

Megjithatë, ndërsa tekste të tilla si vendimet e gjykatës apo interpretimet e instrumenteve ligjore janë më të kuptueshme për shkak të shpjegimit të hollësishëm që i bëhet nocioneve, dhe për pasojë, dhe termave, *acquis communautaire* ka shumë fusha të ngushta specifike, për të cilat mbase ekzistojnë vetëm pak ekspertë të fushës. Në këto raste, të tilla si direktiva për llojet e peshqve, apo rregullore në fushën e të drejtës së pronësisë, është shumë e vështirë për përkthyesin të orientohet dhe të bëjë përkthim të saktë.

Në raste të tilla, puna kërkimore dhe konsultimi me ekspertët e ngushtë të fushës është i domosdoshëm. Siç është theksuar dhe më sipër, *acquis communautaire* mbulon të gjitha fushat e organizimit të shoqërisë, kështu që për asnjë përkthyes, sado profesionist të jetë ai, nuk mund të ketë njohuri të thelluara në çdonjërin prej këtyre fushave. *Acquis communautaire* është i pafund. Për këtë arsye është e udhës që përkthyesit të specializohen në një fushë ose në disa fusha të përafërta dhe të formojnë grupet e tyre të ngushta të komunikimit me ekspertë të fushës dhe me gjuhëtarë, në mënyrë që përkthimi të jetë cilësor dhe që të parandalohen problemet e mëvonshme që mund të shkaktohen nga një përkthim i pasaktë.

Le të shohim një tjetër shembull direktive pjesë  
e *acquis communautaire*.

(teksti në gjuhën burimore)

COUNCIL REGULATION (EC) No 1346/2000 of 29  
May 2000 on *insolvency proceedings*

This Regulation should apply to *insolvency proceedings*, whether the *debtor* is a *natural person* or a *legal person*, a *trader* or an *individual*. The insolvency proceedings to which this Regulation applies are listed in the Annexes. Insolvency proceedings concerning *insurance undertakings*, *credit institutions*, *investment undertakings* holding *funds* or *securities* for third parties and *collective investment undertakings* should be excluded from the scope of this Regulation. Such undertakings should not be covered by this Regulation since they are subject to special arrangements and, to some extent, the national supervisory authorities have extremely wide-ranging powers of intervention.

(marrë nga eur-lex.europa.eu)

(teksti në gjuhën e synuar)

RREGULLORJA E KËSHILLIT (EC) Nr. 1346/2000, datë 29  
maj 2000 për *procedurën e falimentimit*

Kjo Rregullore zbatohet për *procedurën e falimentimit*, si për *personat fizikë* dhe për *personat juridikë*, si për *subjektet tregtare* dhe *për individët*. Proceset e falimentit mbi të cilat zbatohet kjo rregullore renditen në Shtojca. Proceset e falimentit që përfshijnë *sipërmarrjet e sigurimeve*, *institucionet e kreditimit*, *sipërmarrjet e investimeve*, që mbajnë *fonde* ose *sigurime* për palët e treta, dhe për *sipërmarrje kolektive investimesh*, përjashtohen nga objekti i kësaj rregulloreje. Këto sipërmarrje nuk trajtohen nga kjo Rregullore pasi janë objekt i rregullimeve të posaçme, dhe



deri në një farë mase, autoritetet mbikëqyrëse kombëtare gëzojnë kompetenca të gjera ndërhyrjeje mbi to.

Në mënyrë që përkthyesi të jetë në gjendje të përkthejë një dokument të tillë, është e nevojshme që ai fillimisht të dijë se çfarë është *procedura e falimentimit*. Sipas teorisë klasike qëllimi i vetëm dhe përfundimtar i të gjitha procedurave në procesin e falimentimit është dëshira për të realizuar realisht të drejtën e kreditorëve të një sipërmarrje (në një aktivitet tregtar apo prodhues) në krizë, në mënyrë të barabartë lidhur me ekzekutimin e detyruar kolektiv që është i nevojshëm të ndërmerret për shkak të mungesës së *aftësisë paguese (insolvency)* në anglisht) të shoqërisë tregtare (debitorit) në krizë.

Sipas pikëpamjeve më moderne dhe tendencave që paraqesin legjislacionet e falimentimit sot, qëllimi i procedurave të falimentimit është ai i eliminimit nga tregu i sipërmarrjeve (shoqërive tregtare) në krizë, kur vazhdimësia e aktivitetit të tyre rezulton jo frytdhënëse për ekonominë në përgjithësi.

Po ashtu, kur përkthen këtë dokument, përkthyesi ndër të tjera, duhet të dijë që institucionet e kreditimit janë institucione jo bankare që luajnë rolin e bankave për dhënie e kredive për personat fizikë ose juridikë të interesuar, por që kanë më pak burokraci dhe organizim të ndryshëm nga bankat. Ndërsa kur flitet për sigurimet është fjala për sigurinë e kredive, të kontratave (apo detyrimeve të tjera) për të siguruar respektimin e kushteve të rëna dakord paraprakisht ndërmjet palëve.

Siç mund të shihet nga shembujt e mësipërm, në kuadrin e punës së përkthyesit terminologjia nuk ka të bëjë vetëm me gjetjet e fjalëve të duhura në përkthimin në tekstin burimor, por mbi të gjitha me kuptimin e tekstit dhe të

nocioneve që kërkohet të shpjegojë apo të trajtojë dokumenti objekt përkthimi.

Mbi të gjitha përkthyesit duhet të respektojnë parimin e konsistencës ligjore. Lidhur me terminologjinë teknike është e nevojshme të theksohet se përkthyesi duhet të përsërisë herë pas here të njëjtin term në vend që të përdorë sinonime. Përdorimi i sinonimeve në terminologjinë teknike gjatë përkthimit të *acquis communautaire* nuk rekomandohet pasi mund të çojë në krijimin e përshtypjes që bëhet fjalë për koncepte të ndryshme. Në mënyrë që e drejta të jetë funksionale, parimi i konsistencës gjuhësore nuk zbatohet vetëm për tekstin nën shqyrtim, por për të gjitha instrumentet e tjera të lidhura me të. Për pasojë, kur përdorin barasvlerësit përkthyesit duhet të marrin gjithnjë parasysh terminologjinë e përdorur në instrumentet që janë në fuqi. Për shkak se tekstet autentike konsiderohen si përfundimtare, gjuha e tyre ka statusin e precedentit. Kjo do të thotë që kur është përdorur një barasvlerës për një koncept të caktuar në çdo tekst autentik, përkthyes të tjerë janë të detyruar të përdorin të njëjtin barasvlerës edhe pse mund të jenë të mendimit se ai nuk është barasvlerësi i duhur (Šarčević 1990:163). Për pasojë, një ndër pyetjet e para që duhet të bëjnë përkthyesit e një teksti autentik është: “A ka precedentë përkthimi?” (Morgan 1982:213).

Instrumentet autentike për çështje të njëjta ose të ngjashme janë materiale të detyruesme për përgatitje për çdo përkthyes. Si instrumente normative të së drejtës, ato kanë autoritetin e precedentit kurdo që përmendet një dispozitë a një pjesë e caktuar e tyre. Për pasojë, përkthyesve u kërkohet të citojnë referimin e saktë në të gjitha referencat dhe/ose citimet nga tekstet autentike. Për pasojë, është bërë tashmë rregull që përkthyesit nuk duhet të korrigjojnë gabimet dhe të përmirësojnë gjuhën e përkthimeve zyrtare që kanë fuqinë e ligjit. Sipas Koutsivitis, krijimtaria e përkthyesit është e kufizuar tek ato pjesë të teksteve që e lejojnë kreativitetin.



### **Përfundime dhe Rekomandime**

Pjesa e fundit e punimit vjen si përfundim logjik i trajtimit të temës së procesit të përkthimit të *acquis communautaire* në gjuhën shqipe dhe i përvojës në përkthimin në praktikë të *acquis*-it. Ajo duhet të shihet e lidhur ngushtë me përfundimet e dhëna në fund të secilit kre.

Në epokën tonë të telekomunikacioneve dhe internetit, komunikimi shumëgjuhësh është fakt i pranuar i jetës së përditshme. Globalizimi i tregtisë, tregjeve financiare dhe përpjekjet e Shqipërisë për t'u bërë pjesë e Bashkimit Evropian, e bëjnë profesionin e përkthyesit shumë të kërkuar. Volumi më i madh i përkthimeve bëhet në Bashkimin Evropian, i cili përbën organizatën me numrin më të madh të gjuhëve zyrtare. Për vende si Shqipëria, *acquis communautaire* i Bashkimit Evropian do të duhet së pari të përkthehet në shqip për të bërë transpozimin e *acquis communautaire* në të drejtën e brendshme të Shqipërisë dhe teksa Shqipëria afrohet më pranë BE-së, asaj së dyti i duhet të njehsojë të gjithë legjislacionin e brendshëm me *acquis communautaire* të BE-së.

Nga njëra anë, e ardhmja e multilingualizimit varet nga aftësia e përkthyesve për të siguruar tekste të besueshme. Për shkak të domethënies dhe ndonjëherë dhe efekteve të patjetërsueshme të përkthimeve të kësaj natyre, çështja e përkthimit nuk duhet të merret lehtë. Për shkak se besueshmëria mund të arrihet vetëm nëse dëshmohet profesionalizëm i lartë në fushën e përkthimeve, përkthyesve u duhet të zhvillojnë aftësitë dhe kompetencën e nevojshme për të qenë në gjendje të përmbushin me seriozitet këtë punë të rëndësishme.

Në ditët e sotme vëmendja kryesore në teorinë e përkthimit ka kaluar nga transferimi ndërgjuhësor në transferimin kulturor (Vermeer : 1986). Si rezultat përkthimi konsiderohet gjerësisht si “*aktivitet ndërkulturor*” ndërsa

përkthyesi është transformuar në ndërmjetës kulturor. Përkthyesi ka marrë rolin e prodhuesit aktiv të tekstit dhe përzgjedh me vetëdije strategjive të përkthimit mbështetur tek faktorët ndërgjuhësorë (Neubert dhe Shreve : 1991), veçanërisht tek funksioni (qëllimi) i tekstit në gjuhën burimore dhe tek kushtet e situatës komunikuese të përqimit të informacionit. Pra, me të drejtë, përkthimi i akteve dhe i teksteve normative konsiderohet si formë komplekse veprimi. Në këtë mënyrë teoria e përkthimit është bërë *teori në veprim* (Wilss : 1992). Duke i ndihmuar përkthyesit të vlerësojnë aspektet pragmatike të situatave të caktuara komunikuese, *teoria e veprimit* bëhet *teori në veprim* (Newmark : 1988), çfarë presupozon intuitë dhe inkurajon kreativitetin si pjesë e kompetencës së përkthyesit (Wilss : 1988).

Sipas Beaupré, studiues i qasjeve ndaj përkthimit, kurdo që është e mundur përkthyesit duhet të formulojnë dy versione “të barabarta” të të njëjtit instrument, të cilat përpjekjen jo aq shumë të realizojnë “paralelizmin verbal dhe gramatikor” sesa “puritetin gjuhësor” brenda kufizimeve të “barasvlefshmërisë ligjore” (1896:179). Gjatë përpjekjeve për të arritur barazpeshën ndërmjet “puritetit gjuhësor” dhe “barasvlefshmërisë ligjore” epërsi duhet të ketë gjithmonë kjo e fundit. Si rezultat, përkthyesi duhet të marrë parasysh kriteret ligjore dhe kur merr vendime gjuhësore.

Procesi i përkthimit nuk fillon në momentin kur përkthyesi ulet përpara kompjuterit dhe fillon e shkruan në gjuhën e synuar mesazhin e transmetuar nëpërmjet gjuhës burimore. Ai nis me mësimin e gjuhëve, të gjuhës amtare që në fëmijëri, dhe të paktën të një gjuhe të huaj, sa më shpejt të jetë e mundur.

Për të qenë në gjendje të përkthejë cilësisht, përkthyesi duhet pikësëpari të *njohë shumë mirë gjuhën amtare*. Kur flitet për njohje të gjuhës amtare për arsye të përkthimit të *acquis communautaire* nuk bëhet fjalë vetëm për kuptim të thelluar të temave të përgjithshme, apo për

mundësinë e kuptimit dhe përdorimit të zhargonit dhe fjalorit të përditshëm, por për aftësinë e përdorimit të regjistrit formal të gjuhës, të stilit zyrtar, përdorimin e terminologjisë dhe të zhargonit që është i zakonshëm në këtë lloj pune. Gjuha është instrument në zhvillim. Ajo është shumë e larmishme, dhe për shkak të zhvillimit të fushës së përkthimit të *acquis communautaire*, gjuha pasurohet me terma dhe nocione të reja, të panjohura më parë as për ekspertët juristë dhe as për përkthyesit.

Për të forcuar të kuptuarit dhe shprehitë e tij në gjuhën ligjore, përkthyesit të ardhshëm i duhet të njihet me sistemin e brendshëm juridik dhe me konceptet bazë të këtij sistemi. Atij i duhet po ashtu të kuptojë mirë organizimin dhe funksionimin e Bashkimit Evropian, të dijë se cili institucion ka të drejtën e iniciativës ligjore, të shqyrtimit të projektakteve, apo të miratimit të tyre. Ai duhet të dijë ndryshimet stilistike ndërmjet direktivave, rregulloreve, opinionëve dhe rekomandimeve. Pra, në mënyrë që dikush të bëhet përkthyes premtues, atij i duket të paktën një formim i përgjithshëm juridik. Më shumë akoma do të preferohej studimi i thelluar në një fushë të caktuar të së drejtës.

Po ashtu përkthyesit i duhet të njihet me formulimet, ose strukturën e instrumenteve të BE-së, nëpërmjet përkthimeve të sjella në shqip nga përkthyes të tjerë me përvojë dhe që janë mundësisht të redaktuara nga juristë.

Po ashtu përkthyesit e rinj në moshë a në profesion është mirë të lexojnë analitikiht vendimet e gjykatave të brendshme dhe arsyetimet juridike për çështjet që trajtohen në to. Shumë nga vendimet e Gjykatës së Lartë jepen të detajuara dhe të arsyetuara shumë mirë vitet e fundit. Ato të shërbejnë jo vetëm për t'u përditësuar me zhvillimet dhe ndryshimet e jurisprudencës, por edhe për t'u njohur në detaje me konceptet juridike, duke e bërë kështu më të lehtë kuptimin e fenomeneve juridike. Këto dokumente të ekspozojnë po ashtu ndaj fjalëve, fjalëformimeve juridike, logjikës së hierarkisë së

normave dhe funksionimit të shtetit të së drejtës.

Po ashtu, për të punuar me gjuhën amtare për qëllime të përkthimit të *acquis communautaire* përkthyesit mund t'i vijë në ndihmë leximi i thelluar dhe analizimi i përkthimit në shqip të versionit të konsoliduar të Traktatit të Bashkimit Evropian dhe të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian (*Albanian translation of the Consolidated Version of the Treaty on the European Union and of the Treaty on the Functioning of the European Union*), përkthyer në shqip nga Ministria e Integritimit Evropian nëpërmjet një grupi përkthyesish dhe redaktuar nga juristë të fushës dhe nga gjuhëtarë. Ky botim përmban versionet e konsoliduara të Traktatit të Bashkimit Evropian dhe të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian, së bashku me shtojcat dhe protokollet përkatëse, pas shtesave dhe ndryshimeve që u janë bërë atyre nga Traktati i Lisbonës, nënshkruar më 13 dhjetor 2007 në Lisbonë, dhe hyrë në fuqi më 1 dhjetor 2009. Botimi përmban edhe deklaratat bashkëlidhur Aktit Final të Konferencës Ndërqeveritare që miratoi Traktatin e Lisbonës. Arsyeja pse rekomandohet ky lexim është që përkthyesit të kuptojnë logjikën e funksionimit të BE-së dhe të njihen me logjikën e termave të tillë si *parimi i delegimit*, *parimi i proporcionalitetit*, *parimi i subsidiaritetit*, *shteti i së drejtës*, *siguria dhe punët e brendshme*, *politika fiskale*, *gyjqësori*, *kompetencat ekskluzive të BE-së*, *kompetencat diskrecionare të shteteve palë*, *shëndeti dhe siguria në punë*, *të drejtat dhe liritë themelore të njeriut*, e me shumë e shumë terma dhe koncepte të tjera.

Një tjetër gjë që u rekomandohet të interesuarve për t'u bërë përkthyes të *acquis communautaire* është të jenë gjithnjë të informuar për zhvillimet kryesore që ndodhin në nivelin e BE-së. Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri ka një faqe zyrtare ku jepen informacionet më të fundit rreth BE-së edhe në gjuhën shqipe, kështu që informimi i rregullt rreth këtyre zhvillimeve është me shumë vlerë për

përkthyesin.

Përkundër përpjekjeve modeste të bëra për hartimin e fjalorëve terminologjikë për jurisprudencë nga disa autorë, që kryesisht janë bazuar në forca të veta, janë edhe disa përpjekje institucionale për hartimin e një glosari të legjislacionit me bashkëpunim profesionistësh të udhëhequr nga Organizata për Siguri e Bashkëpunim Evropian (OSBE-ja) (Hoxha et al. artikull). Disa prej fjalorëve që mund t'u vijnë në ndihmë studentëve apo përkthyesve të rinj janë: korpusi i specializuar i legjislacionit shqip dhe anglisht i hartuar nga Ali Caka ("Korpusi i specializuar i legjislacionit" Prishtinë 2009), fjalori i terminologjisë juridike anglisht-shqip, shqip-anglisht i Shefije Hasanit ("Law Dictionary English-Albanian, Albanian-English, Prishtinë 1998", fjalor termash juridike, ekonomike dhe biznesi, anglisht-shqip të Luan Kacelit, (Kaceli Luan, Fjalor termash juridike, ekonomike dhe biznesi anglisht-shqip, Dictionary of Law, Economy and Business English-Albanian, Tiranë 2002) si dhe Fjalori terminologjik për Drejtësinë, shqip-anglisht dhe anglisht-shqip të Kalo & Associates. Po ashtu institucione të ndryshme ndërkombëtare kanë krijuar glosarë me termat më të hasura prej tyre, si për shembull International Organization for Migration (IOM), UNWomen (Zyra e Kombeve të Bashkuara për Gratë), dhe institucione të ndryshme kombëtare, të tilla si Ministria e Integritit, Ministria e Bujqësisë, etj., por fatkeqësisht glosarë të tillë nuk janë të disponueshëm online.

Përkthyesi duhet të dijë mirë rregullat e drejtshkrimit dhe të pikësimit të gjuhës shqipe. Ai duhet të përdorë si referenca të zakonshme Fjalorin e gjuhës shqipe (i vitit 1954), Ribotim nga "Botimet Çabej", Tiranë 2005; Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe, Akademia e Shkencave, Tiranë 2002; Rregullat e drejtshkrimit të gjuhës shqipe, Akademia e Shkencave, Tiranë 1973 dhe rregulla të posaçme shkrimi të lidhura me teknikën legjislative.



Megjithatë, përkthyesit nuk duhet të mendojnë se mund të gjejnë gjithçka (ose shumëçka) në fjalorë. Një ndër problemet që krijojnë fjalorët, sipas Gémar-i, vjen nga njëra anë, sepse ata sugjerojnë zgjidhje të tipit "*receta kuzhine*" dhe, nga ana tjetër, shembujt që na ofrojnë janë shpesh përkthime dhe jo tekste origjinale. Për më tepër, fjalorët, edhe për arsye metodologjike, nuk mund të sigurojnë të gjitha kontekstet në të cilat mund të përdoret një term. De Groot-i, si Gémar-i, shpreh keqardhjen për faktin se fjalorët nuk ofrojnë kontekstin në të cilin termat që ata sugjerojnë mund të shfaqen si në gjuhën origjinale edhe në gjuhën e synuar. Pra, fjalorët, dhe për termat që përmbajnë, nuk duhet të konsiderohen si mjete shteruese për konsultimin e termave.

Një tjetër burim shumë i mirë dhe i domosdoshëm për përkthyesit janë faqet zyrtare të institucioneve të brendshme dhe të organizmave ndërkombëtare. Po ashtu, kërkimi në internet mund të japë ide për zgjidhje të mundshme të teksteve të ndërlikuara dhe të vështira për t'u përkthyer. Glosarët terminologjikë sipas fushave të ngushta të së drejtës janë po ashtu një instrument i rëndësishëm për përkthyesit.

Një element tjetër shumë i rëndësishëm për të qenë në gjendje të bësh përkthime është ***njohja shumë e mirë e gjuhës së huaj***. Në mënyrë që dikush të fillojë të merret me përkthim ai duhet të ketë nivelin C2 të Kuadrit të Përbashkët Evropian (CEF) dhe nivelin i avancuar dhe shkëlqyer të Standardeve të Nxënies së Gjuhëve të Huaja të Këshillit Amerikan për Mësimin e Gjuhëve të Huaja (ACTFL). Më specifikisht, parametrat gjuhësorë që duhet të përmbushë një përkthyes lidhur me aftësitë në gjuhën e huaj janë si më poshtë: a) të kuptojë pa sforcime praktikisht gjithçka që ai/ajo lexon apo dëgjon; b) të mund të përdorë akte dhe argumente nga burime të ndryshme të shkruara dhe gojore duke i përmbledhur ato në mënyrë koherente, dhe c) të mund të shprehet spontanisht, shumë rrjedhshëm, në mënyrë të saktë dhe të mund të bëjë të

dallueshme nuancat e holla kuptimore në lidhje me tema komplekse.

Përkthyesi duhet t'i referohet gjatë të gjithë kohës fjalorëve në anglisht. Përveç fjalorëve më tradicionalë, të tillë si Oxford, Webster-Marriam, *The Advanced Learner's Dictionary of Current English*, London, 1970, përkthyesi duhet t'u drejtohet po ashtu fjalorëve të specializuar ligjorë, të tillë si Black's Law dictionary, fjalorëve të shumtë online për fushën juridike, glosarëve të DG Translation, të cilët janë të programuar sipas fushave dhe kanë informacion shumë të gjerë rreth termave. Një burim tjetër i rëndësishëm është leximi i vendimeve kryesore të Gjykatës së Drejtësisë së Luksemburgut lidhur me interpretimet që u janë bërë aspekteve të caktuara të së drejtës së komunitetit.

Një tjetër rekomandim për personat që duan të bëhen përkthyes të *acquis communautaire* dhe të përkthyesve të rinj, është krahasimi ndërmjet teksteve origjinale të direktivave, rregulloreve, opinionëve dhe rekomandimeve të BE-së me versionet e tyre të përkthyer në shqip (në rastet kur ato ekzistojnë). Krahasime të tilla të bëjnë të identifikosh pikat e forta dhe pikat e dobëta të tekstit objekt shqyrtimi, dhe ajo çfarë është më e rëndësishmja, të bëjnë të reflektosh për pikat e dobëta dhe të forta individuale. Në një farë mënyre, ky "ushtrim" të bën të mundur të krahasosh aftësitë e tua me nivelin e tregut.

Një rekomandim tjetër që mund t'u vijë në ndihmë përkthyesve, është konsultimi i përkthimeve në gjuhë të tjera të tekstit objekt studimi ose përkthimi. Direktivat, rregulloret, rekomandimet dhe opinionet, si dhe mjaft dokumente pune të Këshillit Evropian, të Komisionit Evropian dhe të Parlamentit janë dokumente që përkthehen në të 24 gjuhët zyrtare të BE-së. Versionet e përkthimeve në italisht, frëngjisht, spanjisht shërbejnë si referenca të mira për kuptimin e teksteve dhe për gjetjen e fjalëve a termave të barasvlefshëm. Përkthyesit, sipas Gémar-it, sugjerohet t'i nënshtrohen një procesi në tri faza.

Faza e parë është leximi dhe analiza e tekstit; faza e dytë është evidentimi dhe paraqitja e termave dhe e nocioneve të panjohura, dhe faza e tretë është kërkimi i barasvlerësve. Studentëve dhe përkthyesve të rinj u rekomandohet që të ndjekin këtë rend pune dhe të mos nisin përnjëherë përkthimin mekanik.

Krijimi i lidhjeve profesionale me profesionistë të mirë të fushës dhe shkëmbimi me ta i problemeve të mundshme dhe i informacioneve përkatëse është një tjetër rekomandim për përkthyesit. Këtu futen dhe profesionistë të gjuhëve të tjera nga Shqipëria dhe nga jashtë.

Për sa i përket trajnimit të studentëve të përkthimit, përkthyesve të rinj në moshë a në profesion, është e rëndësishme të përdoret një qasje që e çon studentin/profesionistin e ri nga faza kognitive, tek ajo asociative dhe më pas tek faza autonome nëpërmjet të cilave mësohen faktet rreth profesionit, detyrës apo projektit të përkthimit dhe procesit që duhet kaluar për të përfunduar projektin. Është e rëndësishme që studentët a përkthyesit e rinj paralelisht me teorinë mbi traduktologjinë të përballen gjithnjë e më shpesh me praktikën e përkthimit, të jenë në gjendje të analizojnë gabimet, të mësojnë t'i eliminojnë ato, të ndërtojnë kapacitetet për të bërë lidhjen ndërmjet pjesëve të ndryshme të procesit dhe të analizojnë sesi këto pjesë të ndryshme kontribuojnë për një punë të suksesshme, të përvetësojnë të gjitha procedurat e përkthimit nëpërmjet një trajnimit të qëndrueshëm dhe praktik aq sa procesi dhe puna e të përkthyerit t'u vijë natyrshëm dhe të dinë si të kërkojnë, si të hulumtojnë, kujt t'i drejtohen për probleme a dilema të ndryshme, dhe si t'u gjejnë zgjidhje problemeve që mund t'u dalin në praktikë.

Për ta ngritur një aftësi të fituar rishtazi në nivelin e ekspertizës, është e nevojshme që praktika e qëllimshme dhe analitike të bëhet pjesë e rutinës së studentëve apo e përkthyesve të rinj. Kjo është mënyra e vetme që bën të

mundur eliminimin e pikave të dobëta, aplikimin e rregullave specifike për probleme specifike dhe ndërtimin e strategjive për zgjedhjen e problemeve të reja dhe të panjohura.

Po ashtu, mënyra sesi praktikohet studenti apo përkthyesi i ri ka ndikim shumë cilësor mbi ekspertizën. Për t'u bërë ekspert me aftësi për t'u përshtatur me problemet që mund të shfaqen, për të qenë në gjendje për të reflektuar mbi strategjitë tuaja dhe për të modifikuar çfarë është e nevojshme për t'u përshtatur me një situatë të re (interpretimi) (Moser-Mercer et al, 2000, Moser-Mercer, 2008), është e rëndësishme që studentët të mos praktikohen pa pasur objektiva të qarta. Në fakt ata duhet t'i ndajnë veprimet e ndryshme në aftësi të caktuara, procedurën dhe mënyrën e të funksionuarit të së cilës ata e kuptojnë. Për t'i fituar këto aftësi individët duhet të përqendrohen dhe të punojnë në mënyrë të ndërgjegjshme. Ky është parimi i praktikës së qëllimshme. Në mënyrë që studentët të jenë në gjendje të bëjnë përparime në këtë drejtim, trajnimi duhet të theksojë të nxënët metakognitiv, organizimin efektiv të njohurive dhe situatat komplementare në të cilat fitohen aftësitë e caktuara (Moser-Mercer, 2008).

Po ashtu, është e rëndësishme të nënvizohet se pavarësisht nga orët e praktikës dhe nga përvoja, për shkak të vështirësisë së fitimit të aftësive të një niveli goxha të lartë, i tillë si përkthimi i *acquis communautaire*, duhet të kuptohet nga të gjithë ndikimi i madh i motivimit, praktikës së rregullt dhe të synuar, të nxënët nga praktika dhe nga gabimet për përmirësimin e performancës dhe për përparimin drejt rrugës së ekspertizës.

Duke marrë parasysh aftësitë që duhen për t'u bërë ekspert, duke u përqendruar tek përkthimi i *acquis communautaire*, është e rëndësishme të njihen teorikisht dhe praktikisht problemet kryesore që dalin gjatë procesit të përkthimit dhe të kuptohet plotësisht procesi i përkthimit. Një porosi e fundit për studentët e gjuhëve dhe ata që dëshirojnë të bëhen përkthyes: bëni sa më shumë të jetë e mundur praktikë

përkthimi dhe identifikoni mënyra e instrumente që ju bëjnë  
njerëz dhe përkthyes më të mirë!

### **Bibliografia**

Alexy, Robert (2010) ‘*A theory of legal argumentation*’, Oxford University Press.

Adams, C. (2002) What is a B Language? *Towards a Working Definition and Selection Criteria, In European Masters in Conference Interpreting. Proceedings of EMCI Workshop Paris 2002: Teaching simultaneous interpretation into a B language.* Paris: ESIT.

Alcaraz, Enrique (1996) ‘*Translation and Pragmatics*’, in Roman Alvares and Carmen-Africa Vidal (eds) *Translation, Power, Subversion*, Clevedon, Multilingual Matters, 99-105.

Alcaraz, Enrique and Brian HUGHES (2002) *Legal Translation Explained.* Manchester: St. Jerome Publishing.

Akehurst, M. (1972). Preparing the authentic English text of the E.E.C. Treaty. In B. A. Wortley (Ed.), *An introduction to the law of the European Economic Community* (pp. 20–31). Manchester: Manchester University Press.

Baker, M. (1992), *In Other Words: A Coursebook on Translation.* London: Routledge.

Baugh, Albert C., and Thomas Cable. 2002. *A history of the English language.* 5th ed. London: Routledge.

Beaupré, Michael (1987) Introduction to “La traduction juridique”, Issue 4; 735-745.

Berberi, Sokol (2012) ‘Arsyetimi dhe shkrimi ligjor’, Shtëpia Botuese MORAVA.

Bialystok E, Craik FIM (2010) *Cognitive and linguistic processing in the bilingual mind*. *Curr Dir Psychol Sci* 19:19 – 23.

Bler, L.K., & Goral, M. (2007). *Bilingual Lexica*. In G. Jarema & G. Libben (Eds.), *The mental lexicon: Core perspectives* (pp. 185-205). Oxford: Elsevier Press. Obler, Goral. 2007.

Beaugrande, R. de (1987). Determinacy distributions in complex systems: Science, linguistics, language, life. *Zeitschrift für Phonetik, Sprachwissenschaft und Kommunikationsforschung*, 2, 147–190.

Boele-Woelki, K. (2008). European challenges in contemporary family law: Some final observations. In K. Boele-Woelki & T. Sverdrup (Eds.), *European challenges in contemporary family law* (pp. 413–423). Antwerp: Intersentia.

Brand, O. (2006–2007). Conceptual comparisons: Towards a coherent methodology of comparative legal studies. *Brooklyn Journal of International Law*, 32(2), 405–466.

Chomsky, Noam (1965). *Aspects of the Theory of Syntax*. MIT Press.

Christopher DeMarco (1982). Review of Wilga Rivers 'Teaching Foreign Language Skills' Studies in Second Language Acquisition, 5, pp 138-141. doi: 10.1017/S0272263100004757.

Canale, M.; Swain, M. (1980). "Theoretical bases of communicative approaches to second language teaching and testing". *Applied Linguistics* (1): 1-47.

Chernov, G.V.(1992): "Conference interpretation in the USSR: History, theory, new frontiers", *Meta*, XXXVII, 1.

Curzon, L. B. (2002). Dictionary of law. (6th ed.). London: Longman.

Gémar, Jean Claude (1987) 'Legal Translation – art or technique of Interpretation', 495-514.

Graddol, D. 2008. Time for Britain to be taught some lessons. *Guardian Weekly* 8 February 2008. [online] (20 Sep 2009) <http://www.guardian.co.uk/education/2008/feb/08/tefl.wordsandlanguage>.

De Groot, A. D. (1965) *Thought and choice in chess*. The Hague: Mouton.

De Groot, A. D. (1966) *Perception and memory versus thought: Some old ideas and recent findings*. In B. Kleimnuntz (Ed.) *Problem solving*. New York: Wiley.

Déjean Le Féal, Karla. 2005. *Can and Should Interpretation into a Second Language be Taught?* In Godijns & Hinderdael. 167-194.



Denissenko J. (1989): “*Communicative and Interpretative Linguistics*”, in *The Theoretical and Practical Aspects of Teaching Conference Interpretation*. Ed. by L. Gran & J. Dodds, Udine, Campanotto Editore, pp. 155-158.

Donovan, Clare. 2005. *Teaching Simultaneous Interpretation into B : A Challenge for Responsible Interpreter Training*. In Godijns & Hinderdael. 147-165.

Ericsson, K, R. Th. Krampe, & C. Tesch-Römer (1993). The role of deliberate practice in the acquisition of expert performance. *Psychological Review* 100, 363-406.

Ericsson, K. (2000/1). Expertise in Interpreting. An expert performance perspective. *Interpreting* 5/2, 187-220.

Ericsson, K. (2004). Deliberate practice and the acquisition and maintenance of expert performance in medicine and related domains. *Academic Medicine*, 79 (10), 70-81.

Gile, Daniel. 2005. Teaching conference interpreting: a contribution. In Tennent, Martha (ed). *Training for the New Millenium*. Amsterdam/Philadelphia: John Benjamins. 127-151.\* *A synopsis of fundamental issues in conference interpreter training*.

Gouin, F. (1880; 1894), *The Art of Learning and Studying Foreign Languages*. Published: London by G. Philip and Son <http://archive.org/stream/artofteachingstu00gouirich#page/n5/mode/2up>

Graddol, D. 2008. *Time for Britain to be taught some lessons*. *Guardian Weekly* 8 February 2008. [online] (20 Sep 2009)

<http://www.guardian.co.uk/education/2008/feb/08/tefl.wordsandlanguage>.

Grosjean, F. 1989. *Neurolinguists, beware! The bilingual is not two monolinguals in one person. Brain and Language*, 36, 3-15.

Grosjean, F. (1998). *Studying bilinguals: Methodological and conceptual issues. Bilingualism: Language and Cognition*, 1(2), 131–149.

Harmer, J.(1983). *The practice of English language teaching [Harmer, 1983]*. London: Longman.

Hiltunen, R. (1990), *Chapters on Legal English. Aspects Past and Present of the Language of the Law*. Helsinki: Suomalainen Tiedeakatemia,.

Hoffman, Robert.(1997). The cognitive psychology of expertise and the domain of interpreting. In *Interpreting* (pp.189-230). John Benjamin Publishing Company. Amsterdam/Philadelphia.

Hymes, D.H. (1972) ‘*On Communicative Competence*’ In: J.B. Pride and J. Holmes (eds) *Sociolinguistics. Selected Readings*. Harmondsworth: Penguin, pp. 269-293.(Part 2)

James, Philip S. (1989), *Introduction to English Law*. London: Butterworths,.

James, Philip S (1998), *More Paragraphs on Translation*. Clevedon: Multilingual Matters Ltd.,.

Kintsch, W (1988). *The role of Psychological Review*, 95, 163-182.

Kiraly D C (1997). *Think-aloud protocols and the construction of a professional translator self-concept*. In J H Danks, G M Shreve, S B Foundatin, and M K McBeath (Eds). *Cognitive processes in translation and interpreting* (pp 137-160). Thousand Oaks, CA: Sage.

Klein, M. *The Psycho-Analysis of Children* (1932), A. Strachey, trans. London: Vintage, 1997.

Klein, G. A., & Hoffman, R. (1993). Seeing the invisible: Perceptual/cognitive aspects of expertise. In M. Rabinowitz (Ed.), *Cognitive science foundations of instruction* (pp. 203-226). Mahwah, NJ: Lawrence Erlbaum Associates.

Krashen, Stephen. *Principles and Practice in Second Language Acquisition*. Oxford: Pergamon Press, 1982.

Krashen, S.D. & Terrell, T.D. (1983). *The natural approach: Language acquisition in the classroom*. London: Prentice Hall Europe.

Kovelman, I., Baker, S. A., & Petitto, L.A. (2008). *Bilingual and monolingual brains compared using fMRI: Is there a neurological signature of bilingualism?* *Journal of Cognitive Neuroscience*, 20(1), 1-17.

Kovelman, I., Baker, S.A., & Petitto, L.A. (2008). *Age of bilingual language exposure as a new window into bilingual reading development*. *Bilingualism: Language & Cognition*, 11(2), 203–223.

Künzli, A. and Moser-Mercer, B. “*Human strategies for translation and interpretation*”. In Dreschler-Fischer, L. and Pribbenow, S. KI-95 Activities: Workshops, Posters, Demos. 19th Annual German Conference on Artificial Intelligence (304-306). Berlin: Springer and Gesellschaft für Informatik (1995)

Laka, I. (2012) *More than one language in the brain*. In Boeckx C., M.C. Horno & J.L. Mendivil (eds.) Introduction to the Biological Study of Language, Oxford: Oxford University Press.

[https://www.academia.edu/2108309/More\\_than\\_one\\_language\\_in\\_the\\_brain](https://www.academia.edu/2108309/More_than_one_language_in_the_brain)

Larkin, J.H., McDermott, J., Simon, D.P., & Simon, H.A. (1980a). *Expert and novice performance in solving physics problems*. Science, 208(4450), 1335-1342.

Larkin, J.H., McDermott, J., Simon, D.P., & Simon, H.A. (1980b). *Models of competence in solving physics problems*. Cognitive Science, 4, 317-345.

Lesgold, A.M., Rubinson, H., Feltovich, P., Glaser, R., Klopfer, D., & Wang, Y. (1988). *Expertise in a complex skill: Diagnosing X-Ray Pictures*. In M.T.H. Chi, R. Glaser, & M.J. Farr (Eds.), *The Nature of Expertise* (pp. 311-342). Hillsdale, NJ: Lawrence Erlbaum.

Levelt, W. J. M. (1989) *Speaking: from intention to articulation*. Cambridge, Massachusetts: The MIT Press.

Marslen-Wilson W, Tyler LK. *The temporal structure of spoken language understanding*. Cognition. 1980;8(1):1–71. [PubMed]

Moser-Mercer, B. (1997). *Beyond curiosity: Can interpreting research meet the challenge?* In J. H. Danks, S. B. Fountain, M. K. McBeath & G. M. Shreve (Eds.), *Cognitive processes in translation and interpreting*. Thousand Oaks, CA: Sage Publishing, 176–195.

Moser-Mercer B., Künzli A. and Korac M. (1998): “*Prolonged turns in interpreting: effects on quality, physiological and psychological stress*”, *Interpreting* 3 (1), pp. 47-64.

Moser, Barbara.(2008). *Skill acquisition in interpreting: a human performance perspective in the Interpreter and Translator Training* (pp.1-28). St Jeromes Manchester.

Moser-Mercer, B (in press). *Acquiring expertise in sight translation*. In S Lambert (Ed), *A cognitive approach to interpreter training*.

Moser-Mercer, B., Frauenfelder, U., Casado, B. & Künzli, A. (2000). *Searching to define expertise in interpreting*. In K. Hyltenstam & B. Englund-Dimitrova (Eds.), *Language processing and simultaneous interpreting* (pp. 107-132). Amsterdam: John Benjamins.

Neubert, Albercht and Gregory M. Shreve (1992) *Translation as Text*, Kent, Ohio; The Kent State University Press.

Newmark, Peter. (1988) *A Textbook of Translation*. London: Prentice Hall International Ltd.

Newmark, Peter. (1991) *About Translation*. Clevedon/Philadelphia/Adelaide: Multilingual Matters.

Nida, Eugene and Charles Taber (1974) *The Theory and Practice of Translation*, Leiden: E.J. Brill.

Obler, L.K., Hyun, J.-M., Conner, P., O'Connor, B., & Anema, I. (2007). *Brain organization of language in bilinguals*. In A. Ardila & E. Ramos (Eds.), *Speech and language disorders in bilinguals* (pp. 21-46). New York: Nova Science International.

Paradis, J., Nicoladis, E., & Genesee, F. (2000). Early emergence of structural constraints on code-mixing: Evidence from English bilingual children. *Bilingualism: Language and Cognition*, 3: 245-261.

Paradis, Michel (1993) "*Multilingualism and aphasia*." In: Blanken et al. (eds). 278-288.

Paradis, M. (1993) *Linguistic, psycholinguistic, and neurolinguistic aspects of "interference" in bilingual speakers: The Activation Threshold Hypothesis*. *International Journal of Psycholinguistics*, 9: 133-145.

Perani D, Abutalebi J, Paulesu E, Brambati S, Scifo P, Cappa SF, Fazio F (2003) *The role of age of acquisition and language usage in early, high- proficient bilinguals: an fMRI study during verbal fluency*. *Hum Brain Mapp* 19:170 –182.

Richards, Jack C. and Theodore S. Rodgers. 1986. *Approaches and methods in language teaching: A description and analysis*. Cambridge: Cambridge University Press. 167pp.

Richards, J.C., Schmidt, R., 2002. *Longman Dictionary of Language Teaching and Applied Linguistics*, third ed. Pearson Education, London.

Rosene, Shabtai (1983) "The meaning of "authentic text" in modern treaty law; New York/Springer, 759-784

Séguinot, C. (Ed) (1989). *The translation process*. Toronto: York University

Šarčević, Susan (1994) 'Translation and the Law – An interdisciplinary approach', Amsterdam/Philadelphia: Benjamins 301-307.

Šarčević, Susan (2000) 'New approaches to legal translation', Kluwer Law International.

Seleskovitch, D. (1968), L'interprète dans les conférences internationales: problèmes de langage et de communication, Paris, Lettres Modernes.

Shreve, G. (1997). "Introduction". In J Danks, G M. Shreve, S B Fontain, and M K McBeath (eds), *Cognitive Processes in Translation and Interpreting*. Thousand Oaks, London and New Delhi: Sage.

Simon, H. A., (1973). *A simulation of memory for chess positions*. *Cognitive Psychology*, 5, 29-46.

Snell-Hornby, Mary (1980) *Translation Studies, An Integral Approach*, Amsterdam: Benjamins;

Solan, L. M., (1993), *The Language of Judges*, Chicago: University of Chicago Press.

Tabory, Mala (1980) *Multilingualism in International Law and Institutions*: Sijthoff & Noordhoff.

Toury, G. (1995) *Descriptive Translation Studies and Beyond*, Amsterdam and Philadelphia: Benjamins

Viaggio S. (1992a): “*Cognitive Clozing to Teach Them to Think*”, The Interpreters’ Newsletter, 4, pp. 40-44.

Weber, Harmut (1982) Language for Specific Purposes, Text Typologies and Text Analysis: Aspects of Pragmatic Functional Approach; Symposium on LSP, Copenhagen, 219-234.

### Fjalorë

Instituti i Shkencave, Seksioni i Gjuhës e i Letërsisë, Fjalor i Gjuhës Shqipe, Tiranë, 1954.

Fjalor i gjuhës shqipe (i vitit 1954), Ribotim nga “Botimet Çabej”, Tiranë 2005.

Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Fjalor i Gjuhës së Sotme Shqipe, Tiranë 1980.

Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë, Fjalori i Shqipes së Sotme, 2002.

Hasani Shefije, Fjalor i terminologjisë juridike anglisht – shqip, shqip- anglisht, Law Dictionary English-Albanian, Albanian-English, Prishtinë 1998.



Kaceli Luan, Fjalor termash juridike, ekonomike dhe biznesi anglisht-shqip, Dictionary of Law, Economy and Business English-Albanian, Tiranë 2002.

Modern Dictionary of International Legal Terms, Boston, Little, Brown & Co.

Osborn's Concise Law Dictionary (8th ed. 1993), ed. Bu L. Lutherford dhe S. Bone, London, Sweet and Maxwell.

Webster, thefreedictionary,

[www.legal-dictionary.thefreedictionary.com](http://www.legal-dictionary.thefreedictionary.com)

Black's Law dictionary, <http://thelawdictionary.org>

Law – Merriam-Webster-online, <http://www.merriam-webster.com>

Fjalorit terminologjik për Drejtësinë, shqip-anglisht dhe anglisht-shqip të Kalo & Associates.

Grup autorësh, *The Advanced Learner's Dictionary of Current English*, London, 1970.

### **Faqe interneti**

<http://ec.europa.eu>

<http://www.coe.int>

<http://ec.europa.eu/dgs/translation>

Kuadri Evropian i përbashkët i referencës për gjuhët shkarko nga <http://www.coe.int>

<http://www.cym.edu.hk/english/Hkcee/Collocation.htm>

[www.mie.gov.al](http://www.mie.gov.al)

[http://europa.eu.int/abc/eurojargon/index\\_en.htm](http://europa.eu.int/abc/eurojargon/index_en.htm)

[http://www.coe.int/t/dg4/linguistic/source/framework\\_en.pdf](http://www.coe.int/t/dg4/linguistic/source/framework_en.pdf)

[https://startalk.umd.edu/resources/NCSSFL\\_ACTFLCanDos.pdf](https://startalk.umd.edu/resources/NCSSFL_ACTFLCanDos.pdf)

<http://www.coe.int/t/dg4/education/elp/elp>

[reg/source/key\\_reference/overview\\_CEFRscales\\_EN.pdf](http://www.coe.int/t/dg4/education/elp/elp/reg/source/key_reference/overview_CEFRscales_EN.pdf)

[http://www.coe.int/t/dg4/linguistic/cadre1\\_en.asp](http://www.coe.int/t/dg4/linguistic/cadre1_en.asp)

[www.ec.europa.eu/translation](http://www.ec.europa.eu/translation)

<http://www.buzzle.com/articles/law-terms-glossary-of-legal-terms-and-meanings>